



**ENVER HOXHA
NË FILLIM
ISHTE ANTIKOMUNIST**
E fsheshta që dinte Ali Këlcyrë

YLLI POLOVINA

Shtator 2021

YLLI POLOVINA

ENVER HOXHA NË FILLIM ISHTE ANTIKOMUNIST

E fsheshta që dinte Ali Këlcyra

Shtator 2021

© Copyright

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij vëllimi nuk mund të riprodhohet, memorizohet apo përcillet në ndonjë formë a me ndonjë mjet elektronik, mekanik, me anë të fotokopjes, në disk ose në mënyra të tjera, përfshirë dhe kinemanë, radion, televizionin, pa autorizimin me shkrim nga autori.

Libri është gratis.

Secili që e dëshiron për ta lexuar t'ia bëjë kërkesën autorit në adresën elektronike:

yllipolovina@gmail.com

PASQYRA E LËNDËS

Shfaqet Enver Hoxha

Tre vizita

Por çfarë thotë vetë Hoxha?

Vazhdon të pohojë kryekomunisti

Saktësime

Për komunistët shqiptarë

Në një letër drejtuar Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Gjirokastrën

Pakti fantazmë

Italianët djegin Këlcyrën

“Protokoll-Nderi” apo thjesht një protokoll i pandershëm?

Letra shpjeguese e gjeneralit Renco Dalmaco

Nuk gjendet dokument i firmosur

Sipas një interpretimi të PPSH

Jeta e gjeneralit Renco Dalmaco sipas italianëve

Mustafa Matohiti nuk pranoi të shtrëngonin duart

4 maj 1943

Rrëmbimi i Ali Këlcyrës nga një çetë partizane

Shkëmbim pengjesh

Enver Hoxha pohon se nuk e ka liruar ai Ali Këlcyren e kapur nga partizanët

Dëshmitari me emrin Avdyl

Roli i Shefqet Peçit në ngjarje

Dëshmia e dytë

Sulm propagandistik prej komunistëve, thashetheme kundër tij nga disa bejlerë

Një trakt i gushtit 1943

Fjalimi i Enver Hoxhës në Labinot, 6 shtator 1943

Shtëpi me qira në Tiranë dhe në Fier

Teatër dhe vrasje në mes të Fierit

Enver Hoxha urdhëron vrasjen e Ali Këlcyrës
1944, viti i morrave në Ballkan

Shfaqet Enver Hoxha

Për ta uruar lindjen e vajzës së Ali Këlcyrës dhe të bashkëshortes së tij Advije Didush hanëm Vrioni, Hanës, në një nga ditët e mes marsit 1936, u erdhi në shtëpi edhe Enver Hoxha.

Hana pati lindur në 8 mars.

Sipas çfarë tregon për jetën e vet, por edhe rezulton nga dëshmitë e të tjerëve, këtë muaj Enver Hoxha duhej të ndodhej në Bruksel, duke kryer punën e ndihmësit të konsullit të nderit të Shqipërisë në Belgjikë, industrialistit francez Maroth Marothi.

Tre vizita

Sipas asaj që Hana ka treguar pas vitit 2007, ardhjes së saj të parë në Shqipëri, “Fillimisht babai im është takuar në Paris me Enver Hoxhën, tre herë para vitit 1939.

Herën e parë është kur vdiq vëllai i babait, Faik Këlcyra.

Ai vjen në vitin 1935 për të ngushëlluar me një kuti me puro.

Ndërkohë që herën e dytë për lindjen time”.

Pa e përcaktuar si herë të tretë Hana Klissura përmend rastin kur Hoxha i erdhi në banesë Aliut me një letër nga Bahri Omari.

Kur në fillim të muajit shtator 2016 i kërkova një radhë të këtyre vizitave të Enver Hoxhës në shtëpinë e Ali Këlcyrës, Hana më ktheu këtë përgjigje: “Herën e parë ka qenë kur vdiq Faiku në 1935, herën e dytë kur lindi unë edhe të tretën kur kërkoi të hynte në Bashkimin Kombëtar, dhe pastaj, më duket, që nuk u takuan më, as edhe në Shqipëri”.

Pastaj plotësoi: “Po ky Enver Hoxha që ka qenë atëherë student në Francë ka ardhur për të uruar që unë kisha lindur në Paris...”

Por Enver Hoxha kishte ardhur edhe një vit më parë tek babai për të ngushëlluar për vdekjen e Faikut dhe kishte prurë, siç ishte zakoni, një kuti me puro.

Më vonë erdhi edhe një herë për të takuar babanë me një letër prej Bahri Omarit, shokut të ngushtë të tim ati, sepse donte të hynte në Bashkimin Kombëtar me qenë që nuk kishte dhënë provimet edhe ishte në rrezik të humbiste bursën që i kishte dhënë qeveria e Mbretit Zog me ndërmjetësimin e Ekrem bej Libohovës, por babai e refuzoi. E shau rëndë, duke i hequr vërejtjen që ai kishte zënë vendin e një studenti të mirë për të cilin Shqipëria kishte nevojë, ndërsa ky harakopesh nëpër Paris...

Edhe këtu nis hasmëria e Enver Hoxhës për babanë që ishte më shumë personale se politike”.

Ndërkohë në vijim të intervistës dhënë një gazete të Tiranës pa u mbyllur moti 2010, Hana Klissura e shpjegonte kështu këtë ngjarje të fundit përplasjeje mes Enver Hoxhës dhe Ali Këlcyrës: “Herën e parë që ka qenë në Itali tek kunati, edhe i jep Bahriu një letër për babanë.

Brenda ishte: “Ali të lutem, ndihmoje se ka disa kërkesa sepse e kam kunat”.

Dhe babai e pyet dhe Enveri kërkon të hyjë në Bashkimin Kombëtar.

Nga Faiku, babai e dinte se kishte një bursë të shtetit dhe që nuk i kishte kaluar disa provime.

Kur zoti Hoxha i thotë babait se dua të hyj edhe unë në Bashkimin Kombëtar, i cili kishte si synim të rrëzonte mbretërinë e Zogut, babait i thotë: “Si kërkon të hysh, ndërkohë që t’i je me bursë të mbretit Zog”?

Babai i thotë Enverit: “Nuk të vjen turp që me paratë e shtetit dëfren, i ke zënë vendin një tjetër studenti që mund të kishte studiuar?”

Ai i tha se “edhe nëse do të ishin paratë e babait tënd, duhej të të vinte turp sepse do të kishte dërguar me djersë. Ne nuk jemi organizatë bamirëse”.

Por çfarë thotë vetë Hoxha?

Sipas librit të tij me kujtime “Vite të rinisë”, Tiranë 1988, “Në Paris u njoha edhe me emigrantë politikë, si Kol Tromarën, Qazim Koculin, Ali Këlcyrën, Beqir Valterin e të tjerë.

Të gjithë luanin kumar, poker dhe merrnin pjesë në bastet për garat e kuajve, me përjashtim të Sejfi Vllamasit dhe të Rexhep Mitrovicës”.

Hoxha shkruan se me të gjithë ata, prej miqve të përbashkët prezantohej si i kunati i Bahri Omarit.

Pastaj mëshon: “Ata as që merreshin fare me politikë, për Shqipërinë as e çanin kokën fare, pse ishin larg e njerëz nuk shkonin në Paris, si në Bari.

Këta farë politikanë nuk kishin as unitet të paktën shoqëror me njëri-tjetrin, ata vetëm të luanin kumar dinin dhe përpiqeshin kush të rripte shoqi-shoqin.

Para merrnin mirë, kushedi nga ç’grazhd, jo vetëm jetonin në apartamente që kushtonin, por të gjithë frekuentonin kafenetë e mëdha, si “La Coupole” në Montparnas.

Rrallë i shihje në kafenetë popullore, si “Doupont” që kishte në çdo rrugë”.

Këtë opinion Enver Hoxha e përsërit tek libri tjetër i tij me kujtime “Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re”: “Fare i afërt nga përbërja klasore dhe nga pikëpamjet me “Bashkimin Kombëtar” ishte edhe i ashtuquajturit “Grupi i

Zarës”, që mori emrin nga qyteti dalmat, ku Benito Musolini mbante si rezervë Mustafa Krujën me shokë e ia tundte para Ahmet Zogut sa herë donte t’i bënte presion.

Mustafai hiqej sikur ishte në armiqësi me krerët e “Bashkimit Kombëtar”, si Ali Këlcyra me shokë, se këta në vend të lirtave preferonin frangun francez dhe dinarin jugosllav”.

Në po këtë libër, njëherë tjetër, duke ngulur këmbë se disa prej eksponentëve të Ballit Kombëtar morën poste qeveritare gjatë pushtimit (të parin akuzon Mehdi Frashërin), “vetë Ali Këlcyra, dhëndri i Vrionasve, aleati i tyre, natyrisht dhe i Verlacëve, nuk mori nëpunësi, me sa di unë, në mënyrë që të mund të hiqej edhe për ca kohë si “patriot i kulluar”.

Në një rast të tretë në librin “Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re” Enver Hoxha shkruan: “Një grup tjetër të kësaj kategorie të emigracionit politik përbënin “demokratët antizogistë” të Parisit.

Këtu bënin pjesë Ali Këlcyra, Kolë Tromara, Qazim Koculi, Sejfi Vllamasi, Rexhep Mitrovica e të tjerë, por Tromara, Ali Beu, Koculi e Mitrovica hiqeshin si kapot.

Në fakt asnjëri nuk e njihte tjetrin për udhëheqës, sepse të gjithë “udhëhiqnin”, por këta ishin udhëheqës të erës, komandantë pa ushtarë”.

Disa paragrafë më pas Hoxha përsërit pikëpamjen e vet se këta politikanë merrnin financime nga qeveria franceze, ajo italiane, madje edhe në dollarë, se jetonin mirë dhe luanin kumar.

Vazhdon të pohojë kryekomunisti

Duke iu rikthyer një çast pohimit të Hana Klissurës për tre vizita të Enver Hoxhës tek i ati në Paris, na duhet të bëjmë disa plotësime.

Faik beu, i vëllai më i vogël i Ali Këlcyrës, sipas Eqrem bej Vlorës, nuk ka vdekur në 1935, por një vit më herët.

Sigurisht në këtë të ndodhur Hana nuk ka qenë, sepse do të lindte dy mote më vonë.

Vizitën ngushëlluese të Hoxhës ia ka treguar patjetër i ati. Enver Hoxha këtë çast duhet të ketë qenë në Paris, sepse bursa nga qeveria shqiptare iu pre në shkurt 1934.

Ai qe regjistruar për studime në degën e botanikës në universitetin e Montpeljesë në nëntor 1930 dhe pas pothuaj katër vitesh nuk i kishte kapërcyer shumicën e provimeve.

Në kujtimet e veta Hoxha e lë të mjegullt muajin për ku nga Montpelje u nis për në Paris, por këtu e pohon se ndenji vetëm dhjetë muaj.

Po ashtu ai nuk e saktëson kur u nis për në Bruksel, në detyrën e ndihmësit të konsullit të nderit Marothi, por nënkuptohet se kjo duhet të ketë ndodhur në fundvjeshtë 1935.

Siç po ashtu Enver Hoxha shkruan në librin “Vite të rinisë” “Aty nga fundi i qershorit dhe fillimi i korrikut 1936 u ktheva definitivisht nga jashtë...”

Këto pozicionime të kohës i bëjmë për t'i verifikuar me çfarë provash Hana Klissura thotë se prania e Hoxhës në shtëpinë e të atit ka qenë tri herë.

Duhet që ai të ketë qenë në Paris kur ndërroi jetë Faik beu, po ashtu nuk duhet të ketë qenë këtu kur lindi Hana, por në Bruksel.

Ai u largua nga kryeqyteti i Belgjikës drejt Shqipërisë kur ajo ishte pesë muajsh.

Por atëherë kur ka ndodhur përafërsisht biseda e qortimit të ashpër të Ali Këlcyrës ndaj Enver Hoxhës për çështjen e bursës studimore që merrte nga Zogu e ndërkohë donte të regjistrohej tek “Bashkimi Kombëtar”?

Enver Hoxha në librin e tij me kujtime “Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së Re” fillimisht vë në dukje një portret të Ali Këlcyrës dhe vetëm pastaj ndërhyr për të kujtuar Protokollin me Dalmacon: “Më kishte rënë njëherë rasti të takohesha me feudalizmin “demokrat” përpara luftës, kur isha student në Francë. Më duket se kthehesha nga Shqipëria, ku kisha qenë për pushime dhe në Bari kisha takuar Bahriun, i cili më kishte dhënë një letër për Ali Këlcyrën që banonte në Paris.

Sipas adresës që më kishte dhënë Bahriu, i vajta beut në shtëpi.

Kishte një apartament shumë të mirë, gjë që më bëri përshtypje e mu duk e çuditshme për një emigrant.

Aliu më priti ftohtë e me fudullëk e mezi më futi në sallon.

Vetëm kur mori vesh se kush më kishte dërguar, e ndryshoi tonin, më dha një cigare e i ra ziles për të thirrur shërbëtoren franceze, së cilës i tha të më bënte një kafe.

Gjatë kohës që piva kafënë më pyeti për çfarë studioja e ç'kishim nga Shqipëria.

Beu i Këlcyrës më dëgjonte me indiferentizëm e si me bezdi. Atëherë dhe unë i qëndrova akull dhe pyetjeve të tjera iu përgjigja fare shkurt dhe, me të pirë kafënë, u ngrita e ika.

Që atëherë nuk ia kisha parë fytyrën as jashtë, as në Shqipëri, kur erdhi bashkë me pushtuesin.

Po për bëmat e tij, ama, kishim dëgjuar.

Ali Këlcyra ishte ndër propagandistët e shquar të reaksionit e të Ballit, ishte nga ata që villte vrer më shumë kundër luftës për çlirim, kundër komunistëve e partizanëve.

Jo vetëm kaq, se tradhtari Ali Këlcyra nuk mbetej vetëm te llafet; ai bashkë me bashibozukët e vet u qëndronte përkrah trupave italiane në operacionet ndëshkimore kundër krahinave, ku luftonin çetat e batalionet tona, ai digjte e vriste, godiste pas shpine.

Për të gjitha veprimet e tij ne ishim në dijeni dhe e kishim paralajmëruar, dikur edhe e arrestuam, po e lamë të lirë duke i thënë që të kishte mendjen, se herë tjetër nuk do të shpëtonte mirë”.

Saktësime

Kemi përshtypjen, prej faktesh të tërthortë, që momenti kur Hoxha kërkoi të regjistrohej tek “Bashkimi Kombëtar” duhet të ketë qenë periudha e para shkurtit 1934, moment kur iu pre bursa.

Qortimi i Ali Këlcyrës, ku ndodhej edhe togu i fjalëve “të të vijë turp” dhe arsyeja përse e gjykonte të pacipë (“përdor për dëfrim bursën e Ahmet Zogut dhe ndërkohë kërkon të regjistrohesh në një organizatë antizogiste!”), i ka të gjitha gjasat të jetë e fund motit 1933.

Me studimet e nisura në Universitetin e Montpeljesë në fundvjeshtë 1930, viti i mësipërm është ai kur stili i sjelljes “dandy” të Enver Hoxhës e mbushi kupën, duke shkaktuar jo vetëm shumë fjalënaja tek shqiptarët në Francë, por edhe shqetësim në Ministrinë e Arsimit në Tiranë.

Duke mos pasur prova që ta vënë në verifikim nëse kjo skenë me “të të vijë turp” ka ndodhur vërtet apo jo, ose e rrëfyer prej Ali Këlcyrës përbën vetëm një pjesë të saj, nuk duam të largohemi nga thelbi: Enver Hoxha e ka vizituar Ali Këlcyrën në apartamentin e tij në Paris plot tri herë.

Për komunistët shqiptarë

Në raportimin e tij për oficerin britanik të zbulimit Ali Këlcyra do të shkruante edhe këto fjalë: “Ne megjithatë, gjatë verës së vitit 1942, patëm disa bisedime të fshehta me udhëheqës të PKS-së së porsaformuar, duke synuar të përcaktonim një program unik për veprime kundër pushtuesit, duke iu sugjeruar që të linim mënjanë përkohësisht divergjencat ideologjike e të përqendronim tërë forcat në formimin e një organizate të përbashkët e kompakte që të drejtonte luftën kundër pushtuesit.

Por fatkeqësisht argumentet tona se përçarja do të sillte dobësimin e luftës kundër armikut dhe se fashizmi do të përfitonte nga kjo për ta thelluar hendekun e ndarjes mes nesh e për ta çuar drejt luftës civile, ranë në vesh të shurdhër.

Të gjitha rrekjet tona të pareshtura dështuan falë kryeneçësisë së papajtueshme të këtyre ambiciozëve të fandaksur.

Në këto takime vumë re se komunistët ishin të vendosur ta bolshevizonin Shqipërinë nën maskën e luftës për çlirimin e vendit dhe ishin të etur për ta pasur tërë pushtetin në duart e tyre.

Pjesa më e madhe e udhëheqësve të tyre, të dështuar në të gjitha fushat e veprimtarisë së deriatëhershme, e shihnin

luftën botërore si mundësinë e fundit dhe të vetme që u mbetej për të marrë shpejt pushtetin.

Na u krijua bindja e patundur se komunistët shqiptarë ishin më shumë arrivistë sesa idealistë, por ajo që na tmerroi më shumë ishte konstatimi se ata ishin vegla të bindura në duart e agjentëve sllavë.

Ndaj i paralajmëruam në mënyrë të prerë e të qartë se nuk do të prananim në asnjë mënyrë që të përsëritej nga të njëjtët protagonistë në kurriz të popullit shqiptar aventura e 1924-ës”.

Në një letër drejtuar Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Gjirokastrën

Për herë të parë Enver Hoxha, firmosur me pseudonimin Tarasi, e përmend Ali Këlcyrën në 23 shkurt 1943, në një letër drejtuar Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Gjirokastrën.

Në të ka udhëzime për pjesëmarrjen e domosdoshme të delegatëve të partisë së mësipërme në konferencën e saj të parë në shkallë vendi.

Ajo u mbajt katër javë më pas, në 17-22 mars, në Labinot të Elbasanit.

Teksti është ky: “Keni plotësisht të drejtë që t’ju ketë ardhur shpirti në hundë nga plehurat reaksionare, politikanë të falimentuar, si Bahri Omari dhe Ali Këlcyra me shokë, por punën merreni me gjakftohtësi se çdo gjëje do t’i vijë koha; situata, sigurisht, do të jetë e tillë që për së shpejti do të gjejë vendin gjithsecili dhe, që t’ia arrijmë kësaj dite, kjo varet nga ne komunistët, nga puna jonë me masat, nga zhvillimi i luftës sonë, nga disiplina e hekurt dhe dashuria e madhe për Partinë, prej nga rrjedh dashuria e madhe për popullin dhe për lumtërinë e tij”.

Pakti fantazmë

Në 17 mars 1943 në konferencën e parë të PKSH-së të mbajtur në Labinot të Elbasanit rezolucioni i saj formuloi mes të tjerash se “Një pjesë e nacionalistëve është grumbulluar në “Ballin Kombëtar”.

Aty në përgjithësi nuk ka pikëpamje të njëjta dhe të qarta për sa i përket Luftës nacional-çlirimtare, pjesëmarrjes në qeverinë e tanishme dhe disa çështje të tjera politike.

Aty ka një pjesë të madhe, dhe sidomos poshtë, që e do Luftën Nacional-Çlirimtare dhe ka shumë mundësi që të hyjë në rrugën e vërtetë të kësaj lufte. Shumë elementë të “Ballit” kanë luftuar dhe vazhdojnë të luftojnë me armë në dorë kundër okupatorit.

Me këta ka shumë mundësi që të bëhet një front luftarak nacional-çlirimtar i përbashkët.

Por është për t’u shënuar se një pjesë e krerëve të “Ballit” është thellësisht konservatore dhe bie në pozitat e kompromisit.

Ata bëjnë politikë me dy faqe, mendojnë të jenë në lëvizjen nacional-çlirimtare dhe të mos e prishin me okupatorin, mendojnë të kalojnë nga kolltuku në kolltuk dhe ta mbajnë kolltukun sido që të ndryshojë situata”.

Ndërkaq siç Enver Hoxha shkruan në librin e tij të kujtimeve, “Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re”, në dhjetëditëshin e fundit të gushtit 1943, “kur ndodheshin

në Labinot, në një mbledhje të tij Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar e hodhi poshtë marrëveshjen oportuniste të Mukjes dhe vendosi që Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare, për të cilën tani thuajse ishin bërë përgatitjet e duhura, të fillonte punimet më 4 shtator”.

Pak më tej: “Pikërisht në këtë periudhë përgatitore të Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare, ose pak më parë, nëpërmjet shokëve të Tiranës na vjen një ftesë nga Ali Këlcyra, i cili na komunikonte për një mbledhje të “Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë”.

Në vijim të menjëhershëm libri i Hoxhës shënon: “Në prag të Konferencës së Labinotit, pra, në kohën kur Ali bej Këlcyra na ftonë në “komitet”, ne kishim shtënë në dorë një dokument të ri të tradhtisë së tij dhe të Ballit Kombëtar.

Ky ishte “protokolli” i turpit, që Ali Këlcyra kishte nënshkruar në hotel “Dajti” me gjeneralin Renco Dalmaco, ku merrej zotim i hapur bashkëpunimi i ballistëve me trupat fashiste.

Ishte e qartë se ç’përgjigje do t’i jepej ftesës së Ballit Kombëtar, megjithatë lajmërova edhe shokë të tjerë që ndodheshin ato ditë në Labinot.

Nuk thirra ndonjë mbledhje të veçantë për këtë çështje, por shfrytëzoja një rast kur në dhomën ku punoja, ishin mbledhur disa shokë.

Më duket se qenë Spiro Moisiu, Nakoja, Omer Nishani, që kishte ardhur ato ditë pranë nesh, mbase edhe ndonjë tjetër.

U tregova për ftesën e Ali Këlcyrës dhe u thashë:

-Ashtu siç e kemi vendosur, do t'i shkruaj Hysenit (Pseudonimi i shokut Gogo Nushi, në atë kohë sekretar politik i Qarkorit të PKSHE për Tiranën) t'i bëjë edhe njëherë të qartë Ballit Kombëtar se për Mukjen dhe për të ashtuquajturin Komitet për Shpëtimin e Shqipërisë as duhet folur e jo më të marrim pjesë në të.

Besoj se jemi të një mendjeje.

Të gjithë shokët ranë dakord”.

Siç qartë dallohet, PKSHE në mes të marsit 1943 nuk di asgjë për bisedimet mes Ali Këlcyrës dhe Renco Dalmacos, kurse në fundgusht pati vendosur prerë dhe pa asnjë mëdyshje ta refuzonte një marrëveshje të kryer në Mukje midis dërgatës së tyre të drejtuar nga Ymer Dishnica dhe përfaqësisë së Ballit Kombëtar të prirë nga vetë udhëheqësi i saj, Mit'hat Frashëri.

Më 6 gusht Enver Hoxha i kishte dërguar një letër Shafingos (Y. Dishnicës), në të cilën e porosi të mos shpërndahej trakti ku shpallej marrëveshja e dyanshme. Tetë ditë më vonë, në 17 gusht, Hoxha, nën pseudonimin Taras, do t'i niste një letër Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Vlorën, në të cilën shpallte vendimin e marrë për prishje të paktit me nacionalistët.

Në këtë dokument autentik Enver H. e citon dy herë Ali Këlcyrën, madje fort kërcënueshëm dhe me urrejtje.

Dy tekstet janë këta: “Njëkohësisht Balli të qëronte nga radhët e tij elementët kompromisaxhinj si Ali Këlcyra me shokë” dhe “...të fillojnë konferenca të gjëra dhe të gjalla në popull ku t'u tregohet qëndrimi ynë dhe qëndrimi i Ballit, duke demaskuar të gjithë personat që kanë bërë dallavere, që kanë bërë poshtërsira dhe të kërkoni haptazi nga populli

mendimin e tij që me këta njerëz nuk mund të bashkëpunohet.

Si për shembull: Ali Këlcyra ka bërë këtë e këtë, ky është njeri i poshtër, ky ka luftuar kundër lëvizjes, ky ka bërë kompromis me akupatorin, ky është edhe në Ball, prandaj ne nuk mund të bashkëpunojmë me Ballin deri sa ai të mos qitë jashtë elementë të tillë...”).

Në fundgusht 1943, para Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare që, duke filluar prej 6 shtatorit, do të mbahej në Labinot të Elbasanit, PKSH kishte shumë nevojë për të gjetur, duke edhe e sajuar, një shkak e pretext për fillimin e goditjes me armë ndaj Ballit Kombëtar.

Ajo ngjarje që në historinë tonë të Luftës së Dytë Botërore ka marrë emrin e “Protokolli Dalmaco-Këlcyra” ishte e mjaftueshme.

Enver Hoxha thotë se dijeni për të morën në ditët e fundgushtit dhe kjo mund të besohet.

Në rast se do ta dinin para organizimit të dy mbledhjeve përgatitore të bisedimeve për të arritur Marrëveshjen e Mukjes, fundkorrik dhe fillimgusht, PKSH do të mungonte në takim.

Ndërkaq Hoxha nuk e shpjegon se në cilat rrethana morën informacion mbi Protokollin dhe cili në thelb qe ai.

Që këtu nis edhe misteri.

Italianët djegin Këlcyrën

Në vëllimin e parë të historisë së Luftës Nacionalçlirimtare, në faqen 486 të kapitullit “Lufta politike për demaskimin e “Ballit Kombëtar”, pranohet se: “Bashkëpunimi i drejtpërdrejtë i “Ballit Kombëtar” me pushtuesit u kurorëzua me një “protokoll nderi” që u nënshkrua më 15 mars 1943, nga Ali Këlcyra e Nuredin Vlora, në emër të Komitetit Qendror të “Ballit” dhe nga Renco Dalmaco, në emër të komandës eprorë të trupave pushtuese italiane.

Me anë të këtij dokumenti ballistët merrnin përsipër detyrimet (sic) që vijojnë:

“1. Ne sigurojmë, duke marrë çdo përgjegjësi, shkëlqesën Dalmaco, komandant epror i fuqive të armatosura të Shqipërisë se asnjë lëvizje kryengritëse me karakter të përgjithshëm nuk do të ngjajë në Shqipërinë jugore...;

2. Ne japim fjalën tonë të nderit se do të përdorim gjithë ndikimin tonë për të ndaluar...sulmet dhe aktet e sabotimit që mund të kryheshin eventualisht nga elementë armiq;

3. Ne e ndjejmë veten të detyruar të zhvillojmë propagandën e duhur për të ndaluar dezertimet e reja të ushtarakëve, për të inkurajuar rekrutime të reja në ushtri dhe për të siguruar që dezertorët të kthehen sa më shpejt ndër repartet operative”.

Këtë fragment të shkëputur prej Protokollit të Nderit autorët e vëllimit të parë të historisë së Luftës

Nacionalçlirimtare shënojnë se e kanë marrë prej originalit që ndodhet në Arkivin Qendror të Shtetit.

Për të vënë re se prej lëndës së vërtetë janë shkëputur në mënyrë të gjymtuar fragmentet më të prira për interpretime të shumëkuptimshme dhe të domosdoshme për të justifikuar goditjen me armë të Ballit Kombëtar, po paraqesim një tekst që qarkullon si variant shumë më afër të vërtetës.

“Protokoll Nderi

Komandanti i Armatës IX, gjeneral Renzo Dalmazzo, me cilësinë e kryekomandantit të trupave italiane në Shqipëri dhe z. Nuredin Vlora e Ali Këlcyra, si përfaqësues të lëvizjes nacionaliste shqiptare, me qëllim që të reshtin katastrofën dhe ployën nga të dyja anët, të pashmangshme gjatë një operacioni në shkallë të gjerë, vendosën, me miratimin edhe të qeverisë së Tiranës, të nënshkruajnë protokollin e mëposhtëm:

1-Të dy delegatët e lëvizjes nacionaliste i deklarojnë nën përgjegjësinë e tyre personale kryekomandantit të trupave italiane se asnjë kryengritje e përgjithshme nuk do të ngjasë në Shqipëri brenda kohës kur protokollin do të jetë në fuqi.

Ky angazhim do të jetë i vlefshëm, me kushtin që trupat fashiste të lëvizin me mjetet e transportit vetëm nëpër rrugët kombëtare dhe të shmangin depërtimin në zonat e brendshme të vendit ku janë vendosur forcat e rezistencës.

2-Do të shihet si kryengritje e përgjithshme lëvizja në të cilën do të marrë pjesë shumica e popullsisë së katër krahinave të Jugut të Shqipërisë.

3- Të dy delegatët nacionalistë, në rast të aksioneve të forcave komuniste kundër trupave italiane, kërkojnë që ndjekja dhe masat ndëshkimore kundër tyre të kufizohen në pesë kilometra nga të dyja anët e rrugës, për të shmangur kështu dëmtimet dhe vuajtjet e popullsisë, pa dallime ideologjike, nga veprimet e komunistëve.

4- Ky protokoll do të jetë i vlefshëm vetëm për dy muaj, kohë e mjaftueshme për qeverinë për të kryer detyrën e saj ndaj vendit.

Për këtë qëllim, është i domosdoshëm zëvendësimi i armës së karabinierisë me xhandarmërinë shqiptare, të organizuar e armatosur më së miri, dhe krijimi i një ushtrie të pakët në numër e të rekrutuar nga gjiri i popullsisë kosovare”.

Siç rezulton nga krahasimi i të dy teksteve referues si lënda e vërtetë e bocet Protokollit, hartuesit e vëllimit të parë të historisë së Luftës Nacionalçlirimtare i kanë paraqitur opinionit publik vetëm ato pjesë, të cilat qenë të favorshme për trupat pushtuese italiane.

Fragmentet që shkonin në dobi të Shqipërisë, madje edhe të vetë Lëvizjes Nacionalçlirimtare, i censuruan.

Ndërkaq një muaj më pas nga këto përpjekje të Ali Këlcyrës dhe Nuredin bej Vlorës për një marrëveshje që ta ndalte apo kufizonte operacionin ndëshkimor italian, ky në të vërtetë nuk u praps.

Nisi me tërë forcën e vet në 25 prill 1943 në Shqipërinë e jugut, veçanërisht në hapësirën më përvëluese të rezistencës Vlorë-Gjirokastër.

Trupat pushtuese të divizionit “Parma”, shoqëruar në qiell edhe nga avionë vëzhgimi, lëvizën të motorizuara dhe me

shumë mjete të blinduara, në katër drejtime kryesore. Pas pesë ditësh me veprime të egra shtypëse, kur e gjykuan se e patën përfunduar detyrën e frikësimit të popullsisë civile, u tërhoqën prej nga ku qenë nisur.

Gjatë reprezaljeve u dogjën shumë shtëpi dhe kush u dilte përpara arrestohej menjëherë.

Ishte ushtria që hapte rrugën për milicinë, kjo vinte pas saj.

Qe kjo e fundit që kryente terrorin.

Gjatë këtij operacioni ndëshkimor iu vu zjarri edhe Këlcyrës.

Aliu në një letër e paralajmëroi me kohë komandantin partizan Xhelal Staravecka që të tërhiqej nga plani i tij për veprime të ashpra antiitaliane në atë zonë, përfshi edhe Përmetin, “pse tash sa i kam mbaruar ata dyqane në Këlcyrë dhe mos u bëj shkak të m’i djegin”.

Njësitë partizane nuk e zbutën qëndrimin e tyre dhe Përmeti, po ashtu edhe Këlcyra me dyqanet e veta, shumica pronë e familjes homonime, pra vetë Aliut, u shkrumbuan prej armatës italiane.

Komunistët shkuan edhe më tej.

Ata e akuzuan Ali Këlcyrën për bashkëpunim me pushtuesit, edhe pse qe nonsens logjik që ky i fundit të binte dakord me trupat italiane të ndëshkimit që t’i sheshoheshin dyqanet.

Duhet të shtojmë se në mes prill 1943, pra kur operacioni ushtarak fashist ishte në kulmim, pati qenë Ali Këlcyra, i cili sapa pa tymin dhe flakët që dolën mbi çatitë e shtëpive të Gjirokastrës i bëri presion komandës italiane se, sipas studiuesit Nuri Dragoj, “po të mos ndalej zjarri, i gjithë

populli do të rrëmbente armët. Për beun e Këlcyrës, në një rast të tillë, përgjegjës për fatkeqësitë që mund të ngjanin do të ishin vetë ata.

Të njëjtin qëndrim mbajti Ali Këlcyra edhe në takimin që pati me Mehmet Shehun, te Rrapi i Dervenit, në afërsi të Tepelenës.

Ai i tha popullit publikisht se nacionalistët ishin për luftën kundër italianëve dhe dëshironin ta shporrnin atë sa më parë, por duke ruajtur edhe popullin”.

“Protokoll-Nderi” apo thjesht një protokoll i pandershëm?

Studiuesi Kastriot Dervishi në librin e tij gjerësisht të dokumentuar “Historia e shtetit shqiptar, 1912-2005” ka mendimin se “Më 15 mars 1943, në kushtet e sjella nga qeveria e re e Maliq Bushatit, dy anëtarë të Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar si Ali Këlcyra dhe Nuredin Vlora, u përfshinë në projektin e një marrëveshjeje armëpushimi me komandantin e forcave të armatosura italiane në Shqipëri, gjen. Renzo Dalmazzo, në të cilin ata zotoheshin se asnjë kryengritje nuk do të ndodhte në jugun e Shqipërisë derisa të përfundonte organizimi i xhandarmërisë, të cilën e quanin një fitore të madhe.

Është mëtuar se kjo dhe disa të tjera ishin projekte marrëveshjeje.

Në të vërtetë “marrëveshja” që është bërë e njohur, nuk gjeti asnjë zbatim.

Edhe jeta e shkurtër e qeverisë Bushati mund të ishte njëri prej këtyre shkaqeve”.

“Në lidhje me këtë, vijon interpretimin e tij Dervishi, shumë vite më pas, drejtuesi i Ballit Kombëtar, Abaz Ermenji, do të shprehej se nënshkrimi i këtij pakti ishte “një përrallë, një legjendë”.

Sipas tij, “Këlcyra mund të kishte edhe gjëra të tjera, po ishte i papërmbytur dhe merrte iniciativa të kota”.

Ermenji mbron pikëpamjen se Ali Këlcyra kishte vepruar në nisma vetjake dhe nuk kishte pasur mandat për të biseduar”.

Tek libri i Tanush Frashërit kushtuar Ali Këlcyrës “Aristokrati kuqezi” shkruhet: ”Më 4 mars 1943, Maliq Bushati, shtron një drekë intime për një rreth të ngushtë miqsh prej katër të ftuarish, ku gjenden gjeneral Dalmazzo, N. Vlora dhe A. Këlcyra.

Dy ditë më vonë bisedohet normalisht dhe konkretisht. Dalmazzo shkruan se “nacionalistët ekstremistë” nënvizuan pëlqimin e tyre “të marrin kontakt me karakter politik me autoritetet ushtarale në vend të autoriteteve politike kompetente”...Kurse Këlcyra, anëtari më potent i nacionalistëve, vazhdon t’i përmbahet rrugës së tij që: “Programi i nacionalistëve shqiptarë është “Shqipëri e shqiptarëve”.

Nga ana tjetër, vazhdon të mëtojë se “synimet tona nuk kufizohen vetëm me rimëkëmbjen e xhandarmërisë dhe të ushtrisë me karakter tërësisht kombëtar...

Bashkëpunimi nuk zë fill nga një orientim i vetvetishëm psikologjik, por vetëm nga detyrimi moral për të ndalur pushtimin e Shqipërisë së jugut nga ana e trupave bullgare ose sidoqoftë të pengojë gjakderdhjen dhe rrënimet që do të shkaktojë operacioni i paralajmëruar i policisë..”

Kjo bën që të ketë shumë keqkuptime, ndërsa përfaqësuesit e Ballit premtajnë të përpilojnë një projekt-deklaratë të re në mbledhjen tjetër.

Ali Këlcyra paraqiti bocën me titull “Protokoll- Nderi”...”

Ndërkaq në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar” të vitit 2008, botim i Akademisë së Shkencave, zëri për Protokollin

Dalmaco-Këlcyra” shpjegohet: “Dokument që u nënshkrua në Tiranë më 15 mars 1943...” dhe “Me nënshkrimin e këtij dokumenti krerët e B.K. u zhytën më tej në rrugën e bashkëpunimit e të bashkërendimit të veprimeve me pushtuesit italianë kundër Lëvizjes ANÇ të popullit shqiptar”.

Letra shpjeguese e gjeneralit Renco Dalmaco

Në vitin 1949, i përkthyer në italisht, u botua libri i biografisë të mëvonshëm të Titos, por njëkohësisht edhe historikshkruar i Jugosllavisë komuniste, Vladimir Dedijer. Titullohej “Il sangue tradito”.

Nëntitulli ishte: “Relazioni jugoslavo-albanesi 1938-1949”. Si botues vetëidentifikohet “Editoriale Periodici Italiani”.

Kjo shtëpi botuese shtypshkronjën e kishte në Varese.

Me shkronja fare të vogla në ballinë të librit u vendos edhe ky tekst: “Dokumente zyrtare, letra, fotografi, kujtime të koordinuara dhe të përpunuara nga Vladimir Dedijer”.

Në faqen 78 të tij thuhet: “Njëri prej drejtuesve të Ballit Kombëtar, Ali bej Këlcyra, firmosi, në emër të organizatës së vet, në mars 1943, një marrëveshje me komandantin italian Dalmaco për një bashkëpunim në luftën kundër partizanëve”.

Jo pak i shqetësuar nga kjo akuzë publike, e cila mund t’ia ndërlikonte qëndrimin e tij në vendet demokratike të Perëndimit, por edhe duke parë që libri tërhoqi vëmendje të botës politike italiane, Ali Këlcyra kreu një veprim të shpejtë.

Përderisa Tiranën zyrtare nuk e mundte dot të merrte të vërtetën dhe ca më tepër atë të Beogradit, ca më shumë që

të dy palët zotëronin makineri të fuqishme propagandistike për të ngulmuar të kundërtën, ia dërgoi librin, të shoqëruar me një letër, gjeneralit Renco Dalmaco.

Ky e lexoi dhe i dërgoi këtë letër:

“Romë, 19 maj 1950

(Zotit) Ali bej Klissura

(via) Garigliano 65/10

Roma

U njoha me veprën që më dhatë “Gjaku i prerë në besë” të shkruar nga z. Vladimir Dedijer.

Më kujtohet shumë mirë që Ju e z. Nuredin Vlora mu paraqitët nga Shkëlqesia e Tij Maliq Bushati, atëkohë kryeministër i Shqipërisë, si eksponentët e përfaqësuesit e rrymave nacionaliste shqiptare.

Ai takim, zhvilluar ditët e para të majit 1943, kishte për qëllim, sipas Bushatit, të shqyrtonte mundësinë e një modus vivendi në mes të Komandës sime dhe formacioneve partizane nacionaliste me qëllim që të rreshtnim gjakderdhjen nga të dyja anët.

Acarimi i gjendjes së brendshme dhe rrethanave të natyrave të ndryshme, na detyruan ta lëmë mënjanë këtë projekt pa pasur asnjë mundësi zbatimi e kurrën e kurrës të shprehej me shkrim ose konkretisht të protokollohej.

Prandaj domosdo kam të drejtë të deklaroj se pohimet e z. Dedijer janë të pathemelta.

Gjeneral Renzo Dalmazzo

Ish-komandant i Armatës 9

(Komanda Eprore e Forcave të Armatosura në Shqipëri)”

Poshtë letrës ishte firma.

Nuk gjendet dokument i firmosur

Gjatë gjithë një gjysmë shekulli, edhe pse në vitin 1975 e deklaruan se dokumenti autentik ndodhej në Arkivin Qendror të Shtetit, ai nuk u paraqit kurrë i fotografuar, pra si faksimile.

Kjo ngjau edhe kur në vitin 1950, në pikun e ndeshjes me shtetet e Perëndimit, Tiranës zyrtare iu desh të shpërthente një fushatë të furtunshme për të denoncuar persona dhe forca politike të arratisura, të cilat po merrnin pjesë mjaft aktivisht në një operacion disavjeçar për rrëzimin me armë të regjimit të drejtuar nga Enver Hoxha dhe të mbështetur fuqishëm nga sovjetikët.

Me këtë rast ajo, nën mbititullin “E vërteta mbi tradhëtorët e atdheut”, botoi me tirazh shumë të lartë librin “Organizatrat tradhëtore “Balli Kombëtar” dhe “Legaliteti”. Në këtë publikim mes të tjerash shkruhet: “Disa ditë me radhë para nënshkrimit të protokollit u zhvilluan bisedime midis krerëve të Ballit dhe autoriteteve italiane të pushtimit me pjesëmarrjen e kryeministrit kuisling Maliq Bushati e ministrave të tij.

Këto bisedime u mbyllën me një mbledhje që provokoi Maliq Bushati në Hotel “Dajti” më 6 mars 1943, në të cilën merrnin pjesë si përfaqësues të ushtrisë italiane gjeneral Renco Dalmaco (Dalmazzo), komandant i përgjithshëm i fuqive të armatosura italiane në Shqipëri, gjeneral Tuci

(Tuzzi), shef i shtatmadhorisë së forcave italiane në Shqipëri etj.

Nga ana e Ballit Kombëtar ishin të pranishëm anëtarët e Komitetit Qendror të tij Ali Këlcyra, Kol Tromara, Nuredin Vlora si edhe eksponentë të tjerë të Ballit si Sejfi Vllamasi etj.

Në këtë mbledhje qeveria kuislinge, përveç kryeministrit M. Bushati, përfaqësohej nga Javer Hurshiti e tradhtarë të tjerë”.

Libri i mësipërm konsiderohet më i plotësuar për atë kohë me dokumente origjinalë, sigurisht të vendosur sipas teknikave të interpretimit të njëanshëm dhe të manipulimit të opinionit.

Për të dhënë përshtypjen e një botimi mjaft të dëshmuar me fakte ai është i mbushur me pamje të drejtpërdrejta, në pak raste tërësore dhe në të shumtën e herëve të pjesshme, të lëndës burimore të informacionit.

E megjithatë Protokoli Dalmaco-Këlcyra mungon.

Nuk ka asnjë pamje të tij, qoftë edhe në dy-tre centimetra.

Sipas një interpretimi të PPSH

Në vëllimin e parë të librit akademik “Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar” thuhet me këmbëngulje se “Para nënshkrimit të Protokollit u zhvilluan bisedime prej disa ditësh midis krerëve të “Ballit Kombëtar” dhe autoriteteve italiane të pushtimit, u bënë pritje dhe përcjellje zyrtare, me pjesëmarrjen e kryeministrit tradhtar Maliq Bushati e të ministrave të tij.

Katër anëtarë të Komitetit Qendror të “Ballit” me Ali Këlcyrën në krye, qenë të pranishëm në pritjen që dha M. Bushati për gjeneral Dalmacon në 6 mars dhe në pritjen që dha Dalmacoja për M. Bushatin, pas tri ditësh.

Kolë Tromara, anëtar i Komitetit Qendror të “Ballit Kombëtar” ngriti një doli për Viktor Emanuelin III.

M. Bushati nuk e fshihte qenien si anëtar i “Ballit”.

Për emërimin e tij si kryeministër, Jakomoni, sipas pohimit që ka bërë vetë, mori për bazë propozimin e ballistëve.

Ky ishte njëri nga shpërblimet që merrte udhëheqja e “Ballit” prej pushtuesve për detyrimet kundrejt tyre.

Shpërblime të tjera ishin vendimet e autoriteteve pushtuese për t’u njohur të drejtën borgjezisë reaksionare dhe çifligarëve shqiptarë të krijonin një “ushtri shqiptare” dhe një “gjindarmëri shqiptare”.

“Balli Kombëtar” ushqente shpresa të mëdha se me anë të “ushtrisë” e të “gjindarmërisë”, ku mendonte të zinte pozita

të forta, do të siguronte pushtetin politik, kur të mundej Italia.

Ç'nuk bënë ballistët për të krijuar “ushtrinë shqiptare” dhe “gjindarmërinë shqiptare”!

Mirëpo reaksionarët shqiptarë s'ia arritën dot qëllimit.

Ushtria s'u formua, për shkak se rinia nuk pranonte të kryente shërbimin ushtarak.

“Gjindarmëria” u nda më vete nga karabinieria italiane vetëm formalisht.

Por ajo u shtur dhe u prish përpara kapitullimit të Italisë”.

Jeta e gjeneralit Renco Dalmaco sipas italianëve

Kur tekstet informues të Italisë paraqitin shkurtimisht jetën e Renco Dalmacos (Lorenzo "Renzo" Dalmazzo), vënë në dukje se ky ushtarak në vitet 1925-1926 ka shërbyer si shef i Trupave Mbretërore Koloniale Italiane në Somali.

Gjatë luftës së Etiopisë pati komandën e Divizionit 2-të të Eritresë.

Pas shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore ushtroi detyrën e komandantit të Armatës XXI.

Ishte po ai që në pushtimin e Jugosllavisë që në krye të Korparmatës VI dhe u shqua në arritjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me çetnikët.

“Në vitin 1943, thuhet në këto paraqitje, ishte në Shqipëri si komandant i Armatës së 9-të.

Këtu ai siguroi bashkëpunimin e Ali Këlcyrës të organizatës nacionaliste të Ballit Kombëtar për të luftuar rezistencën komuniste”.

Mustafa Matohiti nuk pranoi të shtrëngonin duart

Sipas studiuesit Nuri Dragoj, Ali Këlcyra ka një debat politik me përfaqësues të Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe të PKSH-së në fshatin Goricë të Dëshnicës.

Kjo ka ndodhur në 21 mars 1943, një javë më pas nga dita në të cilën, sipas PKSH, Ali Këlcyra pati firmosur marrëveshjen me komandantin italian të trupave të pushtimit në Shqipëri, gjeneralin Dalmaco.

Në 23 mars Ali Këlcyra në strategjinë e tij ngulmuese për të ndalur revanshin e përhapjes së Partisë Komuniste Shqiptare, organizoi një mbledhje për t'i orientuar njerëzit drejt alternativës së Ballit Kombëtar.

Ndërkohë ai nuk e dëshiroi këtë kuvend të qe tinës Frontit Nacionalçlirimtar, prandaj edhe ftoi në të drejtues lokalë të saj.

Kështu në mbledhje erdhën Mustafa Matohiti dhe Dashnor Mamaqi.

Numri i pjesëmarrësve ishte mbi 400 vetë.

Sipas Dragojit, dy përfaqësuesit e PKSH-së patën vendosur në kodrat përreth Goricës, për arsye sigurie, çeta të armatosura partizane, “të gatshme për të ndërhyrë në rast nevojë. Disa njerëz të beut tentuan t'i ndalonin përfaqësinë e dërguar nga komunistët, por Aliu i këshilloi t'i linin të merrnin pjesë”.

Në atë debat Ali Këlcyra ishte përqendruar në pikëpamjen e tij se fashizmi kishte marrë të tatëpjetën dhe se fitorja qe e sigurt”.

Siç dihet, në këtë periudhë, në 2 shkurt 1943, pati ndodhur ngadhënjimi i Ushtrisë së Kuqe në Stalingrad, çfarë përcaktoi kthesën e ballafaqimit luftarak kundër fashistëve në frontin lindor.

Në fjalën e tij Mustafa Matohiti nuk u mjaftua me shprehjen e qëndrimit të tij kundër Ballit Kombëtar, por i cilësoi atë dhe ndjekësit e asaj organizate si tradhtarë.

Në ato çfarë tha Matohiti ngulmoi që shqiptarët të rrëmbenin armët dhe bashkë me pushtuesit t’i jepnin fund edhe shfrytëzimit nga bejlerët.

Siç shkruan Nuri Dragoj, “Pasi mbaroi fjalën përfaqësuesi i partizanëve, Ali Këlcyra iu afrua dhe i zgjati dorën për ta përgëzuar, por Mustafa Matohiti nuk pranoi të shtrëngonin duart”.

4 maj 1943

Raport i Komandës Supreme të forcave të armatosura italiane më 4 maj 1943: “Më 2 vazhdues A.B.Këlcyra, duke vazhduar aktivitetin e propagandës nacionaliste, ka mbajtur një fjalim në Damës të Tepelenës duk e nxitur popullin që të bashkëpunojë me autoritetet në luftë kundër komunistëve...”.

Po kjo zyrë në 29 maj 1943 vazhdon: “Aktiviteti propagandistik antikomunist i Ali bej Këlcyrës, në këto kohët e fundit, ka pasur rezultate të mëdha si për luftën kundër komunizmit, si për të shtruar popullsinë ashtu edhe për forcimin e çetave të armatosura nacionaliste të cilave u ka dhënë gradualisht një karakter të theksuar antikomunist”.

Rrëmbimi i Ali Këlcyrës nga një çetë partizane

Ishte 11 qershor 1943.

Sipas të bijës së Aliut, Hanës, i ati u nis me autobus që nga Këlcyra paradite dhe qe ulur pranë shoferit.

Kjo zgjedhje e vendosjes së tij dukshëm për këdo që kalonte në rrugë kishte të bënte me një problem që ai ato kohë kishte në njërin gju, të cilin duhej ta mbante sa më shumë të shtrirë.

Ndërsa udhëtonin fare qetësisht një çast pa se rruga u mbyll prej disa pushkëve të kryqëzuara për ta detyruar autobusin të qëndronte.

Sipas rrëfimit të Hanës bërë autorit të këtyre rradhëve, ndaluesit “Urdhërojnë të gjithë pasagjerët të zbresin edhe pyesin kush është prej tyre Ali beu!

Babai thotë se “jam unë”.

Atëherë e njoftojnë që kryetarët e tyre e kërkojnë me urgjencë për një takim, gjë që ngjante shpesh, sepse nuk kishte plasur akoma vëllavrasja, edhe babai ishte ai që kishte më prirje për të pasur këto përplasjet publike”.

Më pas Hana Klissura vijon variantin e saj të ngjarjes: “Babai u tha se ishte gati të shkonte ku donin, por duhej që t’i caktonin ditën edhe vendin, me që në moment ishte vetëm.

Por ata insistonin se ishte urgjent.

Atëherë shoferi që duket ishte njeri shumë i zgjuar, e kupton situatën dhe i thotë babait: “Me që qenka kaq urgjent, ne po të presim këtu”.

Dhe priti me të vërtetë deri sa pa drejtimin që morën të armatosurit.

Kur ata humbën në horizont, i hipi përsëri pasagjerët dhe në qytetin e parë i zbriti të gjithë.

Pasagjerët treguan se Ali Këlcyrën e kishin kapur komunistët”.

Rrëfimi i Hana Klissurës më tej rrjedh me këto fjalë: “Shoferi vazhdon udhëtimin e tij siç e kishte të programuar, por pa marrë më pasagjerë edhe në çdo vend ku duhej të thoshte lajmin, njoftonte çfarë kishte ngjarë. Kështu që në një kohë rekord për ato vite u muar vesh në të tërë jugun e Shqipërisë seç kishte ndodhur.

Edhe juga u ngrit në këmbë.

Atë ditë ishte ditë pazari në Këlcyrë dhe të tërë fshatarët e shkretë i lanë në vend gjënë që kishin prurë për të shitur edhe shkuan për ta shpëtuar”.

Sqaron Hana: “Unë këto gjëra pak i dinja nga babai, por kur ra monumenti i Enver Hoxhës edhe u hapën disa dosje, u ngjet edhe raporti që kishte bërë shoferi me vetëm firmën e tij me qenë se i kishte zbritur pasagjerët.

Pati vënë edhe numrin e targës të autobusit si edhe emrin e tij.

Kështu që pas shumë vjetësh u mund të vërtetohej ky event i papërsëritshëm dhe mbase suksesi i fundit personal i babait tim”.

Sipas Hana Klissurës, “Thonë se Mehmet Shehu nuk e kishte parashikuar këtë zhvillim të gjendjes dhe u trëmb

pak për situatën e re edhe pas 18 ore babai u lirua pas tratativash ku kishte hyrë kryetari i bashkisë së Gjenokastrës, Rasim Babameto, duke burgosur 40 veta me rëndësi të radhëve partizane dhe deklaruar që do të dënoheshin me vdekje nëse baban nuk do ta dorëzonin të gjallë.

Komunistët atëherë nuk kanë qenë akoma aq të fortë sa për ta vrare në Shqipëri, kështu që kishin planifikuar ta kalonin në Greqi, ku EAM-i ishte mjaft i fortë për ta vrarë”. Dhe ja tjetër hollësi, sipas Hanës: “E vetmja çetë e Ballit e kryesuar prej Hysni Lepenicës zuri një vend që ishte parashikuar si një tunel për ta tej kaluar matanë kufirit”. Hana Klissura është e bindur se “Shumica e popullit kërkonin ta rrethonin vendin ku gjindej pak a shumë, por pa përdorur armë se ishte frikë që atëherë ta vrisnin babain ata që e kishin akoma në dorë, duke thënë se u vra gabimisht nga një plumb i përdorur prej atyre që donin ta shpëtonin”.

Shkëmbim pengjesh

Shumë vite më parë një të përditshmeje Hana Klissura mes të tjerash i pati deklaruar: “Gjëja e parë që më ka bërë më shumë përshtypje gjatë luftës ishte kur e zunë babain komunistët për 48 orë”.

Sipas saj, ata që i ndaluan dhe i zbritën “ishin dy djem të rinj të armatosur” dhe se pas këmbënguljes së tyre “babai, por dhe shoferi, e kuptoi se ata po e merrnin peng”.

Po ashtu në gazetë Hana saktëson se pasagjerët shoferi “i çoi në Gjirokastër, i zbriti dhe pastaj shkoi lajmëroi në qytet se Aliun e kanë marrë komunistët. Hysni Lepenica u nis menjëherë dhe shkoi në kufirin shqiptaro-grek, përmes një gryke, pasi kishte frikë se komunistët, duke mos qenë shumë të fortë, mund ta nxirrnin atë jashtë kufijve dhe ta vrisnin, pasi atje s`e njihte njeri”.

Gjithnjë sipas variantit të saj thënë të përditshmes, “Lëshimi i tij u bë nga Qazim Babameto në Gjirokastër.

Ata kishin zënë shumë krerë komunistë dhe i shkëmbyen. Bilé, njëherë mbaj mend që ka thënë zoti Babameto: “Më vjen mirë që shpëtoi për fëmijën e tij, por me vdekjen e tij do t`i kishte bërë më shumë nder Shqipërisë, pasi do vrisnim së paku shumë krerë komunistë”.

Enver Hoxha pohon se nuk e ka liruar ai Ali Këlcyren e kapur nga partizanët

Në librin e tij me kujtime “Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re” Enver Hoxha ka këndin e vet politik dhe po aq ideologjik të rrëfimit të ngjarjes.

Shkruan: “Ai bashkë me bashibozukët e vet u qëndronte përkrah trupave italiane në operacionet ndëshkimore kundër krahinave, ku luftonin çetat e batalionet tona, ai digjte e vriste, godiste pas shpine. Për të gjitha veprimet e tij ne ishim në dijeni dhe e kishim paralajmëruar, dikur edhe e arrestuam, po e lamë të lirë duke i thënë që të kishte mendjen, se herë tjetër nuk do të shpëtonte mirë”.

Po ashtu: “Një punë veçanërisht të ndyrë zhvilloi Ali Këlcyra për të sabotuar qëndresën popullore në Kurvelesh gjatë operacionit që fashistët italian zhvilluan aty në prill 1943, punë për të cilën këta i shprehnin mirënjohje.

Komiteti i Partisë për qarkun e Gjirokastrës e pat paralajmëruar disa herë tradhtarin të hiqte dorë nga veprimtaria sabotuese, mirëpo ai vazhdonte të tijën, sepse zbatonte detyrimet që kishte marrë përpara Dalmacos.

Partizanët, të cilën nuk mund të duronin dot një veprimtari të tillë në zonat që ata i kishin çliruar me aq therori, në fillim të qershorit e kapën Ali Këlcyrën në kohën kur ky po zhvillonte një fushatë për të ngritur popullsinë kundër çetave çlirimtare dhe kundër Partisë Komuniste.

Për këtë ata donin t'ia jepnin gjyqit të popullit, që ta gjykonte e ta dënonte si bashkëpunëtor i fashizmit.

“Balli Kombëtar” ngriti një zhurmë të madhe rreth kapjes së njërit nga krerët më në zë të tij.

Për të shmangur një luftë vëllavrasëse që Partia Komuniste nuk e donte, Komiteti Qarkor i Gjirokastrës udhëzoi të lirohej eksponenti ballist.

Fashistët italianë lëvdoheshin se e çliruan ata nga duart e partizanëve”.

Dëshmitari me emrin Avdyl

Një dëshmuesi tjetër i kësaj ngjarjeje quhet Avdyl Bizhga, i cili nga partizan i thjeshtë në këto çaste më vonë u bë komandant batalioni në Brigadën e Pestë Sulmuese.

Kjo njësi e Lëvizjes Nacionalçlirimtare vepronte në atë zonë. Në pasluftë ai u emërua deri edhe komandant i Gardës së Republikës.

Tani nuk jeton më, por rrëfimin e vet e ka lënë në një libër të shkruar nga Resul Bedo dhe Besim Shyti.

Atje, në faqen 33, ndodhet kapitulli “Mbledhja e Rehovës”. Ai nis me fjalët “Mbledhja e Rehovës u bë fill pas operacionit që bënë fashistët në prill 1943.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues të popullit nga të gjitha fshatrat e krahinës së Kardhiqit dhe të Kurveleshit të sipërm, përfaqësues të Frontit Nacionalçlirimtar dhe përfaqësues të Ballit Kombëtar”.

Më pas Avdyl Bizhga vijon: “Përfaqësues i Ballit ishte Ali be Këlcyra. Ai kish menduar se pas djegieve dhe vrasjeve të shumta që ishin bërë, krahina do të ishte gjunjëzuar.

Ali beu dhe krerë të tjerë të Ballit menduan se kish ardhur koha ta shtrinin influencën e tyre në krahinë.

Në këtë mbledhje parullat e tyre dhe kapadailëku, u demaskuan dhe u rrëzuan nga mbledhja e Rehovës”.

(Kapitulli mbyllet pas nëntë rreshtash të tjerë, pa përshtuar asnjë të dhënë konkrete për çfarë realisht

ndodhi në atë mbledhje, cilat qenë fjalët që u thanë prej përfaqësuesve të dy palëve dhe qëndrimet që mbajtën pjesëmarrësit e shumtë nga populli.

Po ashtu nëse pati debat dhe si ngjau kjo etj., etj.,).

Tek kapitulli tjetër i librit, ai me titullin “Ngjarje e veçantë”, që në fillim shkruhet: “Pas operacionit të prillit 1943, kur italianët dogjën dhe shkatërruan, vranë dhe prenë në zonën e Kardhiqit dhe Kurveleshit, populli i acaruar i kish ngritur këngë Ali Beut që hiqej si patriot”.

Ja edhe vargjet e saj, siç i shkruan autori:

“Beu i Këlcyrës me nam

Që punon për Itali,

Gju më gju me gjeneralë

Garanton diktatori,

Ti e dogje Kurveleshin,

S’le kasolle e shtëpi”.

Bizhga thotë se krijimi i kësaj kënge fillesën e ka pas operacionit ndëshkues të prillit, pikërisht atij aksioni të italianëve, për parandalimin e të cilit Ali Këlcyra sipërmori bisedimet e papërfunduara kurrë me gjeneralin Renco Dalmaco.

Mendojmë kështu sepse sipas historianes Sonila Boçi që vetë Ali Këlcyra, i cili ia ngriti perden e fshehtësisë kësaj përpjekjeje për marrëveshje dhe e pohoi publikisht në një mbledhje populli, ku paraqitnin programet e tyre politike PKSH dhe BK.

Para njerëzve shumë të tronditur nga egërsia e operacionit ndëshkimor italian, ai e shpjegoi gjestin e vet të bisedimeve me komandën italiane si një mënyrë ekstreme për të

shmangur dëmet e mëdha mes njerëzve të thjeshtë e të pambrojtur prej ushtrisë së armatosur deri në dhembë.

Tha se kishte shpresuar shumë në rolin e tij për ta frenuar operacionin ushtarak italian, por këta të fundit ia patën refuzuar propozimet zbutëse.

Ky, vetëpohimi i Ali Këlcyrës për Protokollin, mund të ketë ndodhur në takimin ballafaques të Rehovës përderisa që prej këtij çasti nis të hartohet dhe të ekzekutohet plani i rrëmbimit të tij me qëllim dënimin me pushkatim si bashkëpunëtor i pushtuesve.

Në maj 1943, thotë historiana Boçi, partizanët e zonës së Mallakastrës dhe të Kurveleshit, që tashmë e kishin marrë vesh ngjarjen, nga ky veprim u ndjenë dukshëm të egërsuar.

Drejtuesit e tyre lokalë po ashtu.

Qarkulloi atë kohë edhe kjo këngë dëshmuese e gjendjes së irrituar të përkrahësve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare:

“Aty te Ur’ e Kardhiqit,
Na u bë një vukuaf,
Tre-katër djem të rinisë,
Nga beu duan xhevap.
O bej sonte të urdhërosh,
Si mik vetëm për një natë,
Na fal se s’kemi shampanjë,
S’kemi ballo dhe muzikë,
Kemi qumësht, djath’ e dhallë,
Bilbili ia këthen me grykë.
Ne tradhtarë nuk jemi,
As të shiturë si ti,
Jemi vetëm shqipëtarë,

Beu dallaveraxhi”.

Pas marrjes vesh të lajmit se Ali Këlcyra qe takuar me Renco Dalmacon, çfarë, e ritheksojmë, tashmë ishte pohuar para qershorit 1943 nga ky vetë dhe jo se PKSH e pati siguruar të dhënën në mënyrë të pavarur nëpërmjet kanaleve të saj informues brenda zyrave të italianëve, strategjia e kësaj të fundit qe hë për hë të mos kishte asnjë denoncim publik të paktit.

Si lajm rreptësisht të brendshëm e nënkupton këtë edhe Enver Hoxha në librin “Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re”, ku pohon se dokumentet e para provë për bisedimet e Ali Këlcyrës dhe Nuredin bej Vlorës me komandantin italian të trupave të pushtimit, Renco Dalmaco, u kishin rënë në dorë vetëm në ditët e fundit të muajit gusht.

Në rregullin e mbajtjes “rezervat” përfshiheshin jo vetëm botimet në gazetën “Zëri i Popullit”, por as vendosja nëpër trakte.

Sonila Boçi dëshmon se madje kur një përpjekje e tillë për denoncimin masiv të Ali Këlcyrës u bë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare traktin me atë temë nuk e la të shpërndahej.

Deri në fillim të shtatorit 1943 PKSH-së dhe Enver Hoxhës nuk iu desh ta përdorte, pas refuzimit të marrëveshjes së Mukjes, e hodhi në treg, të manipuluar, në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të Labinotit.

Roli i Shefqet Peçit në ngjarje

Sipas Abdyl Bizhgës dhe librit të tij të kujtimeve, “Pas takimit në fshatin Rehovë, Ali be Këlcyra dhe suita e tij zbriti në qytetin e Gjirokastrës, në follenë e tyre të ngrohtë e të sigurtë.

Kur beu vendosi të largohej nga Gjirokastra, me që, u druhej pritave, e braktisi veturën me të cilën lëvizte zakonisht dhe vendosi të udhëtojë si njeri i thjeshtë me autobus për të shkuar në Përmet, ku ndoshta e prisnin detyrat që kishte marrë nga miqtë e tij italianë”.

Më tej: “Në pranverën e vitit 1943, njësitet e çetës dhe ato të fshatrave të krahinës ushtronin kontroll në rrugët automobilistike për të kapur informatorët e fashizmit dhe të Ballit.

Kështu që patrulla partizane e përbërë nga pesë partizanë të çetës “Çerçiz Topulli”, Demo Fejzo, Sevo Rrapi, Mitat Kondi, Hariz Shalari dhe Foto Anastasi një ditë ndaluan autobusin e linjës dy km larg Urës së Kardhiqit, e njohën beun, e kapën dhe e morën me vete.

As ai nuk u bë për burrë, as xhandarët dhe karabinierët që e shoqëronin nuk u bënë të gjallë.

E lanë beun në baltë.

Kurse partizanët e prunë në bazën e Cepas...”

Bizhga nuk e thotë datën kur ndodhi kjo ngjarje e bujshme.

Sipas rrjedhës së kujtimeve, por edhe të interpretimit jo pak të ideologjizuar të Abdyl Bizhgës, “Kapja e Ali beut ngjalli panik në pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre. Miqtë e beut dërguan nga Gjirokastra një batalion milicësh që thërrisnin “Duam beun ose na prisni!”

Më vonë erdhi edhe një çetë ballistësh dhe së bashku me milicët sulmuan Cepon.

Në Cepo në ato kohë ndodhej vetëm një pjesë e çetës “Çerçiz Topulli” me në krye Karafil Bellon. Pak partizanë ishin, po ishte tërë krahina e gatshme.

Me t’u dhënë sinjali i ngrit në këmbë i madh e i vogël, njësitet e fshatrave zunë shtigjet.

Njësitë ynë Kaparjel-Golem udhëhiqej nga Demo Fejzua që e kish kapur Ali benë”.

Sipas Abdylit, atë ditë Shefqet Peçi dhe krerë të tjerë partizanë të zonës “patën shkuar në disa fshatra të tjera me detyra të luftës”.

Vazhdon me tej rrëfimi: “Karafil Bellua më tha: “Dëgjo o Dule Bizhga! Këtu po bëhet lëmsh. Aty mbi shkëmb mbaje Ali beun se e shikon.

Erdhën me rrëmbim milicët, erdhën dhe ballistët nga Teqe e Zallit e disa nga Këlcyra, e të gjithë thërrasin: “Duam beun”.

Unë s’e liroj pa ardhur Shefqet Peçi.

Lajmëro Shefqet Peçin! I thuaj çfarë të bëjmë. Xhani i vëllait vrapo! Erë të bëhesh!

Dhe unë ia mbatha me vrap. Erë unë, erë Shefqeti.

Te Ura erdhi dhe një batalion bersalierësh dhe u prit me pushkë.

Ku u hapte shteg pepinove Karafili!”

Tregon Bizhga: “Shefqet Peçi do të takohej përsëdyti pas një jave me Ali be Këlcyrën. Takimi i tanishëm ishte krejt i befasishtëm.

Partizanët e kishin arrestuar Ali benë dhe e kishin sjellë në qendrën partizane të Cegos.

Ky takim s’ ishte i barabartë.

Avdyl-më tha Shefqeti-më sill një nga ata partizanët!

I çova dy.

-Shoku Shefqet-thanë ata tërë qejf, ne si s’gjetëm spiunë të tjerë në autobus, arrestuam Ali beun, ky është kryetari i tyre.

-Kundërshtoi?-pyeti Shefqeti.

-S’i lamë kohë shoku Shefqet, po ai veç thotë ca fjalë të huaja audiencë, kërkon që ta presësh në audiencë që ne s’e marrim vesh këtë fjalë.

-Avdyl-mu drejtua sërish Shefqeti-thuaji beut se do ta pres po jo tani se s’kam kohë!”

Sigurisht i gjendur përballë një ndodhie të tillë të papritur, çfarë vërteton se ai arrestim i Ali Këlcyrës nuk ishte kryer me ndonjë urdhër luftarak apo sipas ndonjë direktive partie të ardhur nga udhëheqja e PKSH-së, por as prej ndonjë kuturisjeje të ndonjë drejtuesi lokal.

Në rrethana të tilla, kur një skuadër patrulluese e pati bërë fakt të kryer, me refuzimin e atyre çasteve për ta takuar të rrëmbyerin, Shefqet Peçi nuk donte t’i bënte karshillëk Ali Këlcyrës, por të fitonte kohë duke komunikuar jo vetëm me shefin partiak të të gjithë territorit të Gjirokastrës dhe të krahinave të saj, Bedri Spahiun, por mundësisht edhe me Shtabin e Përgjithshëm dhe Enver Hoxhën.

Vijon më tej rrëfimi: “Shefqeti e priti Ali benë. Biseda me të u bë disi e ashpër.

Ali beu tha: Unë do të protestoj.

-Ju mund të protestoni Ali be, por ne kemi ligjet tona dhe do të veprojmë në bazë të tyre-u përgjigj qetë-qetë Shefqeti.

-Për cilat ligje?-pyeti Ali beu.

-Për ligjet partizane-i tha Shefqeti.

Kurse populli e partizanët i thoshin: Mirë, Ali be, ju e mbani veten për patriot, atëherë ç’duan bersalierët italianë që kërkojnë lirin tuaj?

Ata të quajnë ty “Nostro fratello”.

Pse Ali be, vëlla i italianëve jeni ju?”

Më pas Abdyl Bizhga shkruan se punët u ndërlikuan shumë shpejt dhe duke parë që partizanët nuk po e lëshonin Ali Këlcyrën, milicët e bashkë me ta edhe trupa italiane nga divizioni “Peruxha” sulmuan bazën e Cegos. Përdorën madje edhe artileri.

Por Cepo qëndroi”.

“Kur erdhi urdhri për lirin e beut, shkruan kujtimerrëfyesi, më thirri Shefqet Peçi dhe më tha:

-Dule Bizhga, dorëzoje Ali beun te Ura e Kardhiqit me shkrim. Me proces-verbal, më kupton?

-Si urdhëron-i thashë.

E mora Ali benë dhe me disa shokë e zbrita te Ura e Kardhiqit ku prisnin autoritetet fashiste të vendit.

-Merreni-u thashë-po me firmë ama, merreni dhe më jepni firmën që e morët.

-Mirseardhe Ali bej-i tha kryetari i bashkisë së Gjirokastrës, një kolaboracionist i fëlliqur.

-Më mirë të mos kisha ardhur-tha Ali beu-se më dolën të palarat në shesh.

Unë, si mora firmën që e dorëzova, u largova bashkë me shokët”.

Dëshmia e dytë

E një të pranishmi në ngjarjen e rrëmbimit të Ali Këlcyrës e ka emrin Mersin Mixha.

Ishte trembëdhjetë vjeç kur, pas periudhës si një nga korrierët e vegjël të bazës partizane të Cepos, u rreshtua në radhët tyre pikërisht ditën kur kjo ndodhi.

Sipas tij, qe çeta “Çerçiz Topulli”, e vendosur këtu, e cila kontrollonte në rrugë lëvizjet e ushtrisë italiane.

Ura e Kardhiqit ishte postblloku i saj i përhershëm.

Nuk funksiononte përditë.

Herë dilte për rutinë, herë sepse pati marrë ndonjë të dhënë për persona të kërkuar nga Lëvizja Nacionalçlirimtare që tentonin t’i iknin.

Në 11 qershor 1943 pesë të rinjtë e skuadrës së postbllokut u shfaqën tek ura jo për të kryer në parim veprimin e zakonshëm të kontrollimit të spiunëve apo të bashkëpunëtorëve të pushtuesve.

Mersin Mixha thotë se njësitë partizan pati dalë në rrugë për të zbatuar një vendim të celulës komuniste të çetës.

Në një mbledhje të kësaj të fundit Ali Këlcyra, pas vetëpohimit për takimin me autoritetet e larta pushtuese fashiste dhe gjeneralin Renco Dalmaco, qe shpallur tradhtar dhe vendosur të pushkatohej.

Kërkimi dhe kapja e tij nga luftëtarë të çetës qe në zbatim të këtij vendimi.

Ish-partizani korrier 13 vjeçar në dëshminë e tij dhënë një të përditshmeje shqiptare (gazeta “Telegraf”,1 dhjetor 2013), vë në dukje se “Inati i trupave italiane për këtë arrestim ishte i pamatë”.

Në pasqyrim të kësaj atmosfere Mersin Mixha thotë se erdhën menjëherë në vendngjarje trupa të gjeneralit Ernesto Kiminelo (komandant i divizionit “Peruxha” të vendosur në Gërhot të Gjirokastrës) dhe filloi lufta mes tyre dhe pjesës së paktë të partizanëve të ndodhur në Cepo, vendkomandën e zonës.

Sipas arsyesimit të 13 vjeçarit të atëhershëm, i cili nuk ka ndryshuar gjykim as pas pothuaj shtatë dekadash, mbërritja e njësisë italiane e ka penguar procesin e parashikuar për fatin e Ali Këlcyrës dhe të vendosur prej celulës komuniste të çetës “Çerçiz Topulli”: pushkatimin e tij.

Gjithnjë sipas këtij varianti, asnjëherë të provuar prej burimesh të tjera, duke menduar se trupat e ardhura të pushtuesve, por po ashtu edhe të ballistëve, të cilat në vendngjarje mbërritën të parat e qenë mjaft të nervozuara, mund t’ja dilnin ta çlironin eksponentin e shquar të nacionalistëve, njësi rrëmbyes, i komanduar sërish prej po atij që urdhëroi tek postblloku i Urës së Kardhiqit nxjerrjen nga autobusi i linjës dhe arrestimin e Ali Këlcyrës, Mitat Kondit, është larguar me nxitim nga Cepo. Si do të vepronin me të, akoma nuk kishte ardhur urdhri epror.

Aksionin e mbartjes së shpejtë e ka shoqëruar një vendas i armatosur (Abaz Zholi), njohës shumë i stërveitur i terrenit.

Veprimi i zhvendosjes me forcë i politikanit të arrestuar, të cilin rrëmbyesit, me gjithë kërkesat e bëra prej ballistëve dhe italianëve për tua dorëzuar, por ata as që e shkonin nëpër mend, nga sa kuptohet, ka nisur në mbrëmjen e 11 qershorit.

Ka qenë natë kur grupi i nacionalçlirimtarëve, me pengun e vet në mes, u ngjit në Qafë të Koçës, e cila është majëmali. Mitat Kondi u kishte urdhër anëtarëve të tjerë të skuadrës shoqëruese: “Në qoftë se Ali beu tenton të arratiset, qëllojeni!”

Vetëm të nesërmen, në 12 qershor, eksponenti i lartë nationalist, rrëmbimi i të cilit tashmë kishte vënë në alarm tërë udhëheqjen e Ballit Kombëtar, gjithë komandën supreme të forcave italiane të pushtimit si edhe qeverinë në Tiranë të kryesuar prej Eqrem Libohovës, përfshi edhe një pjesë të opinionit publik, u rrugëtua nëpër shtigje e gjysmëterr dhe u vendos në fshatin Plesat.

Këtu strehë paraburgimi u bë, sipas Mersin Mixhës, shtëpia e banorit Iliaz Mehmeti.

Gjithnjë sipas Mixhës, “në fshat në këtë kohë nuk kishte fare njerëz” dhe se “të gjitha familjet e fshatit u larguan duke shkuar në një përrua të thellë, në disa shpella të përroit, ku pikonte vetëm ujë”.

Ikja e banorëve dhe zbrazja e Plesatit pati ndodhur nga që ushtria italiane e kishte goditur me artileri që herët në mëngjes.

Topat e saj shtinin pa pushim herë nga Ura e Kardhiqit, herë prej Gërhotit dhe ashtu edhe nga ana e Mashkullorës. Kështu në fshatin, ku sapo kishin sjellë udhëheqësin nationalist, u krijua gjendje tepër e vështirë jo vetëm prej

bombardimit, por edhe sepse forcat e Ballit tashmë po merrnin pjesë, bashkë me italianët, në rrethimin ushtarak të Plesatit.

Kjo parathoshte se shumë shpejt mund t'u hipte në kokë të sulmonin dhe Ali Këlcyrën ta çlironin me forcën e armëve.

Por grupi i vogël partizan që e ruante, e dinte mirë se këtë sipërmarrje as ballistët dhe as italianët nuk e admironin aq fort.

Ndërhyrja me forcë mund të shkaktonte vrasjen e politikanit të njohur prej njerëzve të Nacionalçlirimtares.

Në rrethanat kur çfarë do të bëhej me fatin e politikanit të njohur nuk kishte ardhur përgjigja nga udhëheqja ushtarake dhe politike komuniste e zonës së Gjirokastrës, “partizanët dhanë menjëherë ultimatum: nëse ballistët do të hapnin zjarr kundër popullsisë së pafajshme, atëherë çetat partizane do të luftonin ashpër kundër tyre”.

(Në këto çaste të mbushura me tension çeta balliste e Lazaratit dhe ajo e Libohovës ja kishin dalë të kapnin dy partizanë dhe t'i mbanin peng në shkëmbim të lirimit të Ali Këlcyrës).

Shkruan më pas, në variantin e tij të ngjarjes, Mersin Mixha: “Në këtë kohë me urdhër të Qarkorit të Gjirokastrës, personalisht të Bedri Spahiut, u kërkua të mos pushkatohet Ali Bej Këlcyra”.

Gjithnjë sipas variantit Mixha, paralelisht me këtë zhvillim të ankthshëm, i cili nga çasti në çast mund të shndërrohej në një përplasje e madhe lokale me armë dhe kjo të shkëndijonte në të gjithë vendin një luftë civile, “vijnë trupat partizane dhe rrethojnë të gjithë zonën e fshatit Plesat në të katër anët. Në këtë kohë vjen dhe Ismail

Golemi, pjesë e trupave të Ballit dhe me një korrier i thotë Ali Bej Këlcyrës: “Të shpëtova Ali”.

Ai iu përgjigj: “Nuk më shpëtove ti, por më shpëtoi momenti politik, pasi partizanët nuk duan vëllavrasje, se po të donin partizanët ti sot nuk do ta gjeje varrin tim.

Politikisht këta djem qëndrojnë më lart se ne, pasi nga Fronti Nacional Çlirimtar ne jemi dënuar me pushkatim, por ky moment politik na shpëtoi nga pushkatimi.

Sot na kanë falur këta, ndaj largohu!”

Sipas rrëfimit të dikur korrierit trembëdhjetëvjeçar, pas ardhjes së urdhrorit që të lirohej, “trupat partizane e morën Ali Bej Këlcyrën, e hipën në një kalë qëllimisht balash, ku e shoqëruan dy partizanë, njëri nga Plesati dhe tjetri nga Prongjia, partizanë të çetës “Çerçiz Topulli”.

Ata do ta çonin deri tek Ura e Kardhiqit, dhe aty do ta merrnin trupat balliste dhe milicia.

Komanda e çetës kishte dhënë urdhër që nëse vriteshin këta të dy djem, partizanë të çetës “Çerçiz Topulli”, atëherë do të luftohej pa asnjë kompromis kundër trupave balliste dhe trupat balliste të rrethuar në Plesat do të vriteshin.

Ali bej Këlcyra, kur po dorëzohej tek trupat e tij, tha: “Të mos preken këta dy djem, vetëm kur të shkojnë në Manastirin e Cepos dhe të hedhin dy breshëri me plumba atëherë quhet që çdo gjë ka shkuar në vend”.

Kështu ndodhi.

Dy partizanët vazhduan rrugën pa pengesë dhe nga trupa balliste u lanë të lirë”.

Katër truproja për ta mbrojtur

Kur nisi kjo ngjarje fare e papritur Hana Klissura ishte shtatë vjeçe dy muaj.

Pas ardhjes nga Parisi në Këlcyrë në fundgusht 1939, motet e fundit çdo muaj qershor shkante në Fier, atje ku ndodhej fisi i të ëmës, Vrionasit, si edhe çifligu i saj dhe i familjes, i tyre, fshati Muçan.

Gjendej rregullisht në Fier, sepse pas mësimëve private që merrte në vendlindje, provimet shkollore i kryente aty.

Në këtë qytet banuan në shtëpi me qira, emrin e pronarit të njëjës prej tyre Hana edhe tani e mban mend.

Quhej Kol Gjini.

Në 11 qershor 1943, në drekë, ajo u kthye nga shkolla dhe e gjeti të ëmën, Advijen, veshur krejtësisht me të zeza.

Ishte në dhomën e fjetjes së saj dhe të Ali Këlcyrës, duke shkukur flokët dhe rënë kokës me grushte.

Qante me gulçe të forta, me një dënesë që ishte përtej rënkimit prej një plage të rëndë plumbi.

Hana shtangu tek dera e dhomës dhe dy-tri hapa brenda saj i bëri si nëpër ajër.

Pamja e nënës dhe gjestet e saj qenë të paimagjinueshme, të papara kurrë dhe e vogla u mpi e tëra.

Advija e dalloi vetëm pas një çasti dhe pa e ndërprerë atë rit të tmerrshëm kujeje, i tha se komunistët i kishin vrarë babanë.

Hana nuk mundi të shqiptonte qoftë edhe një psherëtimë a çdo tingull tjetër që provonte se e pati dëgjuar çfarë i tha e ëma, por heshtur, mish e kockë bërë si gur, doli nga dhoma.

Shkoi në bahçe, atje ku ndodhej pushi.

Instinktivisht kishte vendosur të hidhej brenda tij dhe të mbytej. Nuk i duhej më jeta pa babanë e saj.

Mbërriti tek buzët e grykës së pusit dhe e kuptoi se ai ishte i lartë dhe pa hipur mbi ndonjë mbështetëse nuk hidhej dot brenda tij.

Atëherë u kujtua se aty afër kishin një qilar me sende përdorimi të përditshëm apo kur vinte stina e vapës së fortë. Mes tyre ndodhej edhe një kosh i thurur me thupra.

Ai qe i lehtë dhe mund ta transportonte deri tek pushi.

Qe edhe i lartë mjaftueshëm, po ta ktheje përmbys, sa për të hipur mbi të dhe prej andej të vinte këmbët tek buzët e murit të grykës dhe kështu ta lëshonte trupin të binte në thellësinë e errët të tij.

I bëri të gjitha këto veprime me saktësinë dhe shpejtësinë e një të rriture dhe kur një këmbë e kishte vënë mbi fundin e koshit e tjetrën tek buza e pusit, ndërroi mendje.

Nuk do të binte në ujë e të mbytej.

Po të vdiste edhe ajo, siç edhe pati vdekur babai, me kë do të jetonte mamaja. Ajo kështu do të shkatërrohej fare.

Hana prej këtij çasti mban mend se në prurjen në vete dhe vendimin e braktisjes së dëshirës për të rënë në ujrat e pusit, duhej të kishte ndikuar edhe era e rëndë, si prej kënetete, që vinte nga poshtë tij.

Zbriti njëzën këmbë nga buza e grykëpusit, tjetrën prej fundit të koshit nga vrapoi drejt dhomës së fjetjes së prindërve.

Iu hodh në krahë të ëmës dhe e puthi pa i thënë asnjë fjalë. Tentativën e asaj dite të 11 qershorit 1943 për t'u vetëmbytur nuk do t'ia tregonte nënës jo vetëm atë ditë apo në ndonjë prej viteve të ardhshëm, por kurrë, deri sa Avdija hanëmi në vitet nëntëdhjetë do të ndërronte jetë.

Pas atij përçafimi Advija i tha të bijës se duhej të niseshin sa më shpejt dhe të kërkonin babanë, kudo të ndodhej, gjallë apo vdekur.

U nisën drejt Këlcyrës ende pa gdhirë mëngjesi i 13 qershorit.

Nata, të cilën sapo e patën kapërcyer të pagjuma, prej disa reve të rënda që patën pllakosur Fierin dhe tërë fushën e Myzeqesë, iu ishte rënduar gjoksi aq shumë sa nuk ngopeshin dot me ajër.

Rruga për të mbërritur në Këlcyrë atë kohë kalonte nga qyteti i Vlorës.

Kur mbërritën këtu shkuan tek sarajet e Vlorajve, ku Advijes i banonin edhe dy motrat e saj, Hadija, e cila ishte bashkëshorte e Eqrem beut dhe Rukija e të vëllait të tij Safa.

Advija, ende shumë e tronditur dhe e paqetë, pasi e dëgjoi që edhe në të gjithë Vlorën ishte përhapur lajmi fatkeq mbi Ali Këlcyrën, nguli këmbë se bashkë me vajzën do të niseshin menjëherë për në Këlcyrë.

Por Hadija, e cila qe shtatzënë dhe të shoqin, Eqremin, nuk e kish pranë sepse ndodhej në Tiranë, menjëherë ndërhyri: "Ne ende nuk e dimë në se Ali Benë e kanë vrarë".

Pastaj shtoi këmbëngulëse: “Unë nuk mund të të lë të shkosh vetëm me një çupë të vogël, sepse në se Ali Benë ndërkohë e kanë liruar mund të të kapin ty si peng që ai të dorëzohet përsëri.

Si mund unë t’i dalë atij përpara në se ty të gjen gjë”.

Advija e shihte në sy të motrën, por dukej krejtësisht e papërqendruar, e gatshme të kryente çdo të papritur. Atëherë Hadija shqiptoi argumentin e saj më të fortë: “Në se ngul këmbë të vesh unë jam e detyruar të të shoqëroj edhe kështu të vë në rrezik fëmijën që pres”.

Qe ky çast kur Advija hoqi dorë nga rrugëtimi kokëshkretë drejt Këlcyrës.

Pranoi që ta priste zhvillimin e situatës pa u larguar nga Vlora.

Hana e vogël, tek e dëgjoji mënyrën se si tezja e saj pati arsyetuar, mbeti e mahnitur.

Hadije hanëmi ishte jo vetëm e zgjuar, por natyrë tepër e vendosur.

Po ashtu karakter i fortë.

Të mbushte plot besim për jetën.

Që prej atij çasti Hana Klissura jo vetëm do ta deshte shumë, por edhe do ta adhuronte si shembull për t’i ngjarë.

Ndërkohë nuk kaluan as dy-tri orë të mesditës së 13 qershorit 1943 kur qyteti u përfshi nën lajmin e ri: komunistët e kishin liruar Ali Këlcyrën.

Atë fillim pasdite të 13 qershorit Hana e vogël nuk qe tek sarajet Vlora, por për të humbur mendjen po e kalonte në Skelë me dy kushërirat e saj, Lejlën, vajzën e madhe të Eqrem beut dhe Merjem Toptanin, e cila ishte dy vjeçe më e madhe, pra rreth nëntë moteve.

Merjemi qe bija e dytë e Safa bej Vlorës dhe e Rukijes. Kur pas shëtitjes në Skelë u kthyen në sarajet Vlora, Afifeja, më e vogla vajzë e Safa beut dhe e teze Rukijes, ato çaste vetëm katër vjeçe, rrinte tek porta e madhe dhe i thërriste plot gëzim Hanës që po afrohej: “Hajde, hajde se të shpëtoi babai!”

Pas pak një lajmëtar mbërriti me një pusullë letër nga vetë Ali Këlcyra.

Të nesërmen, në 14 qershor, pasi lajmprurësi i kishte pohuar Advijes se i shoqi hë për hë nuk do të vinte t'i takonte, por në rastin më të parë patjetër, shtoi se Aliu kishte mjaft punë politike për të bërë nëpër mbledhjet e popullit, ku paraqitnin programet e tyre Balli Kombëtar dhe Partia Komuniste Shqiptare.

Pra, ai do të qëndronte ca kohë në krahinë, në Këlcyrë si edhe në Gjirokastër.

Kështu të dyja, nënë e bijë, u rikthyen në Fier.

Hanës i duhej të paraqitej në shkollë.

Ndërkaq Ali Këlcyra qëndroi në jug dhe prej andej erdhi në Fier, vetëm për dy-tri ditë, pas dy e më tepër javësh.

Do të rikthehej përsëri atje, por më pas do të shkonte edhe në qytetin e Beratit.

8 shtatori, ditëkapitullimi i Italisë, kishte shkaktuar ngjarje nga më të çuditshmet dhe të pabesueshmet.

Hanës, kur i ati u kthye në Fier pas arrestimit që i bënë çetat partizane, i ra në sy se në brez, në krahun e majtë, kishte vënë pistoletën që zakonisht e mbante fshehur dhe nuk e linte kurrë t'i dukej.

Aliu nuk i pëlqente armët as për luftë dhe as për gjueti, siç ishte e vjetër tradita e meshkujve të oxhakut Këlcyra.

Duket ajo që i pati ngjarë e kishte detyruar të merrte masa për t'u vetëmbrojtur.

Katër truprojat, që tashmë pati mobilizuar, nuk i dukeshin të mjaftueshëm edhe pse qenë mjaft të përkushtuar.

Njëri ishte egjiptian, jevgjit siç e quan e folura popullore. Quhej Shaqo.

Tre të tjerët kishin emrat Sadik, Bajram dhe Qemal.

Sulm propagandistik prej komunistëve, thashetheme kundër tij nga disa bejlerë

PKSH vërtet e kishte lënë të lirë, duke refuzuar vendimin e organizatës së partisë të çetës së Cepas për ta pushkatuar, por nuk mund të rrinte duarkryq pa e manipuluar ngjarjen me Ali Këlcyrën.

Ajo përhapri gjithkund akuzën se nëpërmjet ndalimit të përkohshëm që iu bë eksponentit kryesor të nacionalistëve, u provua se këta kishin lidhje të plota me pushtuesin, me fashistët italianë.

Sepse, po të ishte ndryshe, arsyetonin, pra të mos pëlqejë Ali Këlcyra prej tyre, ata do ta kishin lënë pa e marrë në mbrojtje, në mëshirë të fatit.

Nuk do të ndodhte, siç edhe ngjau, të dërgonin për shpëtimin e tij njësi të tëra të ushtrisë.

Po të qe ndryshe, këmbëngulnin njerëzit e PKSH-së, pra të mos e donin, italianët nuk do t'u shpërndanin armë të shumta vullnetarëve të ndryshëm që u vetëmobilizuan për këtë aksion.

Çuditërisht traktet dhe fjalimet e të ngarkuarve nga Partia Komuniste Shqiptare me temën se çlirimi i Ali Këlcyrës i kryer prej fashistëve përputheshin me të njëjtin opinion që qarkullonte edhe mes jo pak bejlerëve.

Këta, të papajtueshëm me sjelljen e njohur antibej të Aliut, me rrëmbimin gjetën një rast fatlum për të t'u gëzuar.

Deklaruan se në mos qe një montazh i sajuar prej italianëve për t'ia rritur qëllimisht prestigjin politik, ishte edhe një ngjarje e thjeshtë që vetë protagonistin e saj e zmadhonte për të shtuar rëndësinë e vetes.

E përhapën këtë dyshim, duke paraqitur si dëshmi mjaft bindëse, se tamam për të krijuar kushtet sa më të favorshme për thurjen e kësaj legjende, Ali Këlcyra atë ditë të 11 qershorit pati lëvizur me autobusin e shoqërisë SATA, ndërkohë që kishte veturë personale dhe përherë pati lëvizur me këtë të fundit

Ndërkohë Hana Klissura pas ardhjes në Shqipëri i ka shpjeguar opinionin publik se “Babai nuk donte të kishte makinë të tij private, përkundër dëshirës së mamasë që e kishte ëndërr një makinë.

Ai nuk na e hapte synë, po thoshte “Merrni një taksi ose udhëtoni në mjetet publike!”

Njëkohësisht autorit të këtij libri Hana i ka pohuar se “Babai ka udhëtuar që ditën kur nga Këlcyra, mbas ardhjes tonë nga Franca, u nis me mamane për në Tiranë, gjithmonë me autobusin e SATA-s. Në se mamaja kishte dëshirë të kishte një auto private babai im ishte kundër, sepse thoshte që me qenë se asnjëri prej tyre nuk dinte ta përdorte auton, dot të na duheshin të paktën tre shofera, sepse ai lëvizte shumë.

Ky ishte luks dhe ne nuk duhej ta bënim për deri sa populli shqiptar, të paktën në anët tona, banonte nëpër shtëpi me dhé të rrahur”.

Një trakt i gushtit 1943

Sipas historianes Sonila Boçi urdhrin për lirim e Ali Këlcyrës e pati dhënë vetë Enver Hoxha, duke saktësuar se “nuk është koha tani” për veprime të tilla.

Këmbëngulja e herë pas hershme se kjo çështje mbeti në të drejtën dhe mundësinë e komitetit qarkor të Partisë Komuniste për Gjirokastrën, si gjest i Bedri Spahiut apo edhe i Shefqet Peçit, pra në nivel lokal, nuk përputhet dot edhe me logjikën më të thjeshtë: arrestimi i figurës së dytë të Ballit Kombëtar dhe njërit prej nacionalistëve më me ndikim në jug të vendit ishte lajm buçitës për vetë Shtabin e Përgjithshëm të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Alarmi dhe përgjegjësia për këtë akt do të shkonte patjetër deri atje.

Pas tre takimeve të Enver Hoxhës në Paris me Ali Këlcyrën, ky ishte “takimi” i katërt i tyre, edhe pse jo fizik.

Tani pozicionet qenë kthyer përmbys.

Ishte Hoxha që e kishte në dorë, madje vetë jetën e tij.

Ky mund të qe një rast për tu shpague.

Shefi i PKS-së doemos që e ndiqte nga shumë afër veprimin e personit që e kishte sfiduar në kryeqytetin francez, duke i tërhequr vërejtjen se me moskorrektesën e tij të ndjekjes së parregullt studimeve në Universitetin e Montpeljesë, i kishte zënë vendin një të riu tjetër bursist nga Shqipëria.

Ka një trakt të gushtit 1943, një “Thirrje e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Vlorën”, i cili dëshmon se dora e Enver Hoxhës qëndron përherë e gatshme të veprojë mbi fatin e Ali Këlcyrës.

Ato çaste komiteti qarkor i Ballit Kombëtar për Vlorën dhe Gjirokastrën pati shpërndarë një proklamatë me thirrjen për t’i shpallur luftë PKSË-së.

Prandaj edhe në traktin e udhëheqjes së kësaj partie shkruhej: “Po kush i bën të gjitha këto? Kush thërret popullin në luftë kundër Partisë Komuniste dhe çetave partizane dhe vullnetare?”

Komiteti Qarkor i Ballit Kombëtar për Vlorë e Mallakastër, disa eksponentë të të cilit predikojnë se janë në luftë të ashpër kundër fashizmit e njëkohësisht shëtisin me vetura me xheneralët dhe me oficerët e lartë të fashizmit si, p.sh., Ali Beu, Bektash Beu.

Çudi është që për Ali Këlcyrën, për një nga eksponentët e Ballit Kombëtar, për çlirimin e tij, të cilin e kishte arrestuar një njësi guerrile, fashizmi u dha çetave të Ballit, “Turmës së gabuar”, pushkë, mitraloza dhe municion që të luftojnë kundër partizanëve.

Pyesim Komitetin Qarkor të Ballit Kombëtar a e bën këtë fashizmi se Ali Beu, profetizuesi i idesë kombëtare, është në luftë të ashpër kundër fashizmit apo pse i shërben shumë mirë dhe në mënyrën më aktive për përcarjen e popullit?

Ndofta Komiteti Qarkor i Ballit Kombëtar nuk e di këtë ndodhje të Gjirokastrës, por si organizatë udhëheqëse duhet të dijë mbi qëndrimin e tij të cilin e quan një nga

eksponentët e Ballit Kombëtar dhe profetozonjës in e idesë kombëtare”.

Fjalimi i Enver Hoxhës në Labinot, 6 shtator 1943

Nga 4 deri në 6 shtator 1943 u mbajt në Labinot të Elbasanit Konferenca e Dytë Nacionalçlirimtare.

Ky kuvend zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtare prej 67 anëtarësh.

Konferenca e dënoi Marrëveshjen e Mukjes dhe e ngarkoi me faj politik Ymer Dishnicën.

Në fjalimin e tij të datës 6 shtator Enver Hoxha shqiptoi edhe këto fjalë: “Po të hidhej në luftë “Balli”, bashkimi do të bëhej nga vuajtjet e njëjta, dhe Ali Këlcyra s’do të kishte fushë veprimi për ndërlikime, megjithëse koordinimi ishte minimumi për marrëveshje.

Lufta që “Balli Kombëtar” i ka bërë Lëvizjes Nacionalçlirimtare është e shumanshme.

Ai e quajti atë komuniste.

Këta duket që bëjnë një luftë ideologjike”.

Në një vend tjetër të referatit të tij Hoxha vë në dukje: “Ali Këlcyra me protokollin që nënshkroi i siguroi rrugën e lirë ushtrisë italiane që të kalojë për të ndjekur çetat nacionalçlirimtare.

Ushtritë e Dalmacos dogjën fshatrat e Vlorës.

“Balli Kombëtar” kujtoi se me këtë mënyrë e dëmtoi Lëvizjen Nacionalçlirimtare, të cilën e konsideron komuniste.

Ali Këlcyra paguante fshatarët e djegur (me paret e Italisë), duke thënë se gjoja fshatrat i dogjën komunistët”.

Pak më poshtë Enver Hoxha u tha delegatëve të Konferencës së Dytë se “Ali Këlcyra shkante kudo në emër të “Ballit Kombëtar” dhe nxiste popullin për të marrë armët kundër partizanëve dhe vullnetarëve”.

Në një rast të katërt Hoxha u shpreh kështu në referatin e tij: “Por “Balli” përherë flet, dhe vetëm flet, për luftë. Vetë anëtarët e “Ballit” e quajnë tradhtar Ali Këlcyrën dhe, më tjetër anë, e kanë Aliun demokartin më patriot”.

Pasi paraqit opinione të tilla edhe për eksponentë të tjerë të organizatës nacionaliste, Enver Hoxha formulon vendimin, cili do të miratohej unanimisht prej pjesëmarrëve të Konferencës së Dytë Nacionalçlirimtare: “Fronti Nacionalçlirimtare dhe PKSH, që e udhëheq atë, siç e shihni, bënë çmos, patën durim të madh, u përpoqën me çdo mjet, edhe me sakrifica, që “Ballin Kombëtar” ta bindnin të hidhej në luftë kundër okupatorëve për çlirimin e popullit.

“Balli Kombëtar” u hodh në luftë kundër popullit, kundër Frontit, kundër PKSH.

“Balli Kombëtar” ose balli tradhtar, u bashkua me okupatorët.

Pra, urat ata i prenë.

Ata do të luftohen pa mëshirë, si tradhtarë dhe bashkëpunëtorë të okupatorëve që janë”.

Shtëpi me qira në Tiranë dhe në Fier

Hyrja e partizanëve në Këlcyrë menjëherë pas kapitullimit të Italisë fashiste dhe ndarjes së saj prej aleancës së mëparshme me Gjermaninë naziste, më pas mbajtja e kësaj qyteze strategjike pothuaj përherë në duart e tyre, e shtrëngoi Ali Këlcyrën ta zhvendoste familjen përfundimisht prej aty.

Pas martesës së nipit, Qemalit, birit të Hilmijes, Milisë siç e thërritnin shkurtimisht, me të bijën e Shevqet bej Vërlacit, ai mori në lagjen e quajtur Tiranë e Re, pranë banesës së të motrës, një shtëpi me .

Herë pas here do të rrinte aty, por me periudha shumë të shkurtra.

Ndërkohë bazën kryesore familjare Ali Këlcyra e zuri në Fier.

Prej këtej ai e kishte më të lehtë të kryente veprimtari politike në qytetin e Beratit, i cili tashmë Ballit Kombëtar i nevojitej si një qendër operative e organizatës për tërë jugun e vendit.

Teatër dhe vrasje në mes të Fierit

Fieri ishte një qytet plot trazim politik dhe Hana e vogël dalloi që simpatizantët për partizanët shtoheshin përherë edhe më shumë.

Madje edhe admiruesit e komunizmit.

Pronari i një rës prej shtëpive të mara me , doktor Musai, një person me një kokë mjaft të çuditshme, krejt pa flokë dhe me formën e një pjepri të gjatë, kishte një vajzë shumë të bukur, bionde, e cila pati ngritur në qytet një celulë komuniste.

Ajo ftoi të anëtarësohej në të jo vetëm një vajzë populli që ishte rritur tek Këlcyrajt, Xhipen, por edhe Shegën, vetë të bijën e Muhamet beut, xhaxhait të Ali Këlcyrës.

Hana në Fier kishte parë edhe një vrasje.

Qe me të vërtetë shumë tmerruese.

Ndodhej duke ecur në rrugën, e cila ndërsa dilte prej qytetit, merrte drejtimin për në Tiranë.

Qe bashkë me guvernanten e saj franceze, të cilën më parë e kishin pasur kushërinjtë Jusuf dhe Shahin Vrioni.

Krejt befasi prej një muri ndanë rrugës qëlluan mbi një njeri të vetmuar që po ecte. Plumbi i hapi kokën, duke i nxjerrë trutë.

Ai u shemb menjëherë përdhe dhe vetëm pas kësaj mbi asfalt nisi të krijojë një pellg gjaku.

Nga llahtari Hana dhe governantja vrapuan pa e ditur se ku do t'i çonin këmbët.

Në mbrëmje të asaj dite të frikshme nëpër qytet u hapën fjalë se ata që patën shtënë qenë komunistë dhe i vrari një i përfulur si spiun.

Të tjerë ngulnin këmbë se ishte një i pafajshëm.

Askush nuk e priste atë egërsi.

Në Fier ato ditë shfaqej një pjesë teatrore me temë ndalimin e vëllavrasjes.

Subjekti i saj paraqiste partizanë dhe ballistë në anë të kundërta, gati të kacafyteshin për vdekje dhe që më në fund nisën të përdornin armët.

Pas përleshjes së përgjaktë nga të dy krahët, për secilën palë, mbeti i gjallë nga vetëm një njeri.

Dëshironin edhe ata të dy ta çonin gjer në fund kasaphanën, por brenda pak çasteve ballisti njohu tek partizani vëllanë e vet prej gjaku.

Teatri e sugjestiononte shumë Hanën e vogël, e fuste në mendime shumë tronditëse.

Kishte qenë ndjekja e një shfaqjeje teatrore, kur ajo pati ndjerë se për shtresën e tyre, të bejlerëve, njerëzit e thjeshtë mendonin jo mirë, madje keq.

Pati hyrë një ditë në sallë bashkë me Xhipen, vajzën e rritur që ndihmonte Advijen, kur një grua që luante në skenë jo vetëm u shfaq me përdore një fëmijë me moshën dhe pothuaj pamjen e Hanës, por edhe vetë ajo ngjante shumë me të ëmën.

Qe vërtet një përngjasim aq i fortë sa vajzës së vogël dhe të vetme të Advije dhe Ali Këlcyrës brenda pak minutave iu ngulit ndjenja se para syve qe vërtet nëna e saj.

Kështu çdo gjest, veprim dhe pësim i aktores në skenë Hana e vuante si të vërtetë për të ëmën dhe familjen e tyre. Në një çast të lojës teatrale aktorja, bashkë me të bijën, shkoi në varreza për të vënë një tufë lulesh përmbi varrin e të shoqit.

Hana spektatore u mbush me mornica, pothuaj e humbi ndjesinë se qe në gjallje.

Iu duk sikur po ikte nga bota, po ndahej prej saj.

Mos kjo skenë me lule mbi një varr parathoshte të njëjtën gjë edhe për të atin, i cili ndodhej çdo ditë i pleksur në një luftë politike që më shumë se me fjalë, bëhej me armë?

Qe duke përjetuar përditë këtë ankth të përgjithshëm, pa u mbyllur java, një shoqe e Hanës, e cila banonte në shtëpinë fqinje, pa u brengosur se mund ta lëndonte, i tha qetësisht se në shtëpinë e Ali Këlcyrës, të Advije hanëmit dhe të saj, ku ndodheshin edhe teze Nafie si edhe Shega, duhej të punonin 7 veta për të mbajtur secilin.

Ishte një llogaritje që vajza e re e kishte bërë mjaft saktë. Hana numëroi shpejt e shpejt: Qenë katër truproje, mësueset e saj, gratë që lanin rrobat, që bënë gjellën dhe merreshin me pulat, me qumështin...

Bëheshin plot 35 vetë.

Enver Hoxha urdhëron vrasjen e Ali Këlcyrës

Në 1 tetor 1943 në një letër të gjatë mbi pesë faqe të daktilografuara, e firmosur prej Enver Hoxhës, KQ i PKSH i drejtohej Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Gjirokastrën ato ditë të liruar nga trupat e kapitulluara italiane, që në paragrafin e parë, me këto fjalë: “Diskretitimi i “Ballit” dhe urrejtja e popullit për të, na duket se duhet të na shërbejë për diçka, jo për të bërë polemikë me fjalë me Ali Këlcyrën me shokë, por t'i spastrojmë ato plehra me forcë e me armë të marrim pushtetin në dorë, të qërrojmë vendin nga bazhibozukët dhe të stabilizojmë rregullin dhe qetësinë”.

Në mbyllje të paragrafit të dytë të letrës gjendet ky tekst: “Balli Kombëtar mund të bëjë njëqind e një promemorie, ne promemoret ia bëjmë popullit tonë dhe aq na bën për punët që do të bëjnë Ali Këlcyra me Bahri Omarin e shokë”. Tre paragrafët e fundit të letrës janë të shkurtra, pothuaj me dimensione telegrami.

Tek i pari i tyre është më vete dhe shumëdukshëm kjo frazë: “Ju rekomandojmë në radhë të parë, të kini kujdesin më të madh për Ali Bej Këlcyrën, ai element aq i poshtër nuk duhet të ekzistojë më”.

Ky është dënimi zyrtar me vdekje.

Patjetër që duhej zbatuar që në rastin më të parë. Komunistët qenë shumë rigorozë me vendimet që merrnin dhe urdhrat e ardhura nga lart.

Në 1 tetor 1943 jeta e Ali Këlcyrës ndahet më dysh.

Nuk e dimë nëse ai e mori vesh këtë gjë ato ditë apo më pas, veç veprimet që kreu prej këtij çasti e tutje e lënë të kuptojë se nga nacionalçlirimtarët priste vetëm më të keqen.

Gjashtë ditë më pas nga letra e mësipërme e Enver Hoxhës, në 7 tetor Mit'hat Frashëri u nisi strukturave të BK në bazë dy urdhra.

I pari, drejtuar “Gjithë komiteteve krahinorë”, komunikonte prerë: “Me qenë se vendi ynë sot ka nevojë ma të ngutshme për rregullë dhe disiplinë, gjithë komitetet, komandat dhe çetat e Ballit Kombëtar porositen që me të arrijtur kjo qarkore të pezullohet çdo operacion luftarak kundër forcave gjermane tash për tash”.

Urdhri i dytë i po asaj dite të 7 tetorit 1943 drejtuar sërish “Gjithë komiteteve krahinorë”, thoshte: “Organizata e jonë ka dashur gjithmonë t'i largohet grindjes dhe gjakderdhjes me partinë Komuniste e prandaj ka pasur një sjellje paqësore. Mirpo shifet se partija Komuniste jo vetëm që nuk respekton marrëveshjen e nënshkruarë në Mukaj, porse na sulmon me çdo mënyrë, si me propagandë ashtu edhe me vrasje.

Prandaj porositeni që çdo sulmi e çdo atentati Komunist t'i përgjigjeni me një herë dhe me po atë mënyrë”.

1944, viti i morrave në Ballkan

Ali Këlcyra vinte në Fier prej qytetit të Beratit hipur mbi një motoçikletë dhe vijonte zakonin e tij të vjetër që të mos i thoshte kurrë Advijes kur do të ndodhej mes familjes dhe po ashtu kur do të ikte.

Përpiqej të kishte konspiracion dhe këtë nuk e kuptonte vetëm e shoqja, por edhe vajza e tyre e vetme, ato çaste tetë vjeçe.

Madje përvjetorin e Hanës, i cili i binte në 8 mars 1944, ata e festuan së bashku në shtëpinë e tyre të tretë të marrë me qira në Fier.

E vogla e priste me mall të madh ditën kur i ati krejt papritur do të shfaqej para portës së shtëpisë dhe do të vraponte me vrik për t'iu hedhur në krahë.

Hana ndihej përherë me ankthin se në atë luftë babai i saj jetonte me kokën në torbë dhe nga çasti në çast mund të vritej.

Atë humbje ajo nuk do ta duronte dot kurrë.

Prej këtij çasti takimi të përmallur me të bijën edhe Ali Këlcyra sa nuk fluturonte nga gëzimi. Ishte momenti i vetëm kur ai e shprehte prindin.

Veç kjo shkaktonte alarm të madh tek Advija.

Ajo nuk dëshironte që vajzës t'i ngjiteshin morrat.

Sepse i shoqi sa herë që vinte prej Beratit e sillte me vete këtë insekt parazit të tmerrshëm.

Ato i ngjiteshin nëpër fshatrat ku shkonte për punë politike.

Ca më shumë ndodhte kjo edhe pse ajo pranverë e vitit 1944 që stina e përhapjes së tyre si asnjëherë në motet e mëparshme.

Viti 1944 ishte viti më i vështirë i Luftës së Dytë, por edhe i morrit.

Nuk lëvrinte vetëm nëpër Shqipëri, por edhe mes luftëtarëve nëpër malet e Greqisë.

Në tokat jugosllave që një morr edhe më i bëshëm në përmasa, madje ishte morri më i shumtë dhe më i madh në të gjithë gadishullin e Ballkanit.

Për ta penguar këtë infektues të rrezikshëm të njeriut Advija kishte ngritur në oborrin e banesës, ku jetonin përkohësisht, një kabinë dushi prej druri.

Ali Këlcyra duhej që nga porta të shkonte në këtë vend pastrimi nga koka tek këmbët dhe vetëm më pas mund të hynte në derën e shtëpisë.

Morrat i dolën më të rrezikshëm se komunistët.

17 shtator 2021